



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024
Nr. Ref.: AGJ 2600/24

AKTGJYKIM

në

rastin KO15/24

Parashtrues

Institucioni i Avokatit të Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit nr.08/L-228
për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit).

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme), i miratuar më Vendimin [nr.08-V-538] e 8 qershorit 2023 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 3 korrik 2023.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit të kontestuar, i cili pretendohet se është në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nënparagrafin (1), paragrafin 2 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 29 (Saktësimi i kërkesës) dhe 30 (Afatet) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 65 (Kërkesa në pajtim me nënparagrafët 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 janar 2024, Avokati i Popullit e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 janar 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimeve [Nr.GJR.KO15/24] dhe [Nr.KSH.KO15/24] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 22 janar 2024, Avokati i Popullit u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua (i) Presidentes të Republikës së Kosovës, (ii) Kryeministrit të Republikës së Kosovës, (iii) Kryetarit të Kuvendit dhe (iv) Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) me ftesën që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet eventuale të tyre ose të deputetëve të Kuvendit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit të Gjykatës. KQZ-së iu kërkuar që nga një kopje të kërkesës t'ua dërgojë të gjitha subjekteve politike të regjistruara, me kërkesën që nëse kanë komente, t'i dorëzojnë në Gjykatë. Kërkesa gjithashtu iu komunikua Sekretarit të Kuvendit, nga i cili u kërkuar që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për Ligjin e kontestuar.
8. Më 23 janar 2024, KQZ-ja njoftoi Gjykatën se kërkesa KO15/24 është dërguar tek të gjitha subjektet politike të regjistruara në KQZ përmes postës elektronike, mënyrë kjo e rregullt dhe zyrtare e komunikimit të KQZ-së me subjektet politike.
9. Më 29 janar 2024, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin si në vijim:

- (i) Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 12 maj 2023;
 - (ii) Raportin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për shqyrtim në parim të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 16 majit 2023;
 - (iii) Procesverbalin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për shqyrtim në parim të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 16 majit 2023;
 - (iv) Vendimin [nr.08-V-538] të 8 qershorit 2023 të Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
 - (v) Procesverbalin e seancës plenare të Kuvendit të shqyrtimit të parë të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 8 qershorit 2023;
 - (vi) Transkriptin e seancës plenare të Kuvendit të shqyrtimit të parë të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 8 qershorit 2023;
 - (vii) Vendimin [nr.08/L-228] e Kuvendit, të 8 qershorit 2023 për shqyrtimin e Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me procedurë të përshpejtuar/shmangie nga afatet procedurale të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 34 (Thirrja e mbledhjes së komisionit), paragrafin 4 të nenit 52 (Rendi i ditës për seancë plenare), paragrafët 1,3 dhe 8 të nenit 76 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione) të Rregullores së Kuvendit;
 - (viii) Raportin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 8 qershorit 2023;
 - (ix) Procesverbalet e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 8 qershorit 2023;
 - (x) Vendimin [nr.08-V-562], e 8 qershorit 2023 të Kuvendit për miratimin e Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
 - (xi) Procesverbalin e seancës plenare të Kuvendit të 8 qershorit 2023;
 - (xii) Transkriptin e seancës plenare të shqyrtimit të dytë të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 8 qershorit 2023; dhe
 - (xiii) Ligjin nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i miratuar nga Kuvendi më qershor 2023, dhe i shpallur me Dekretin e 29 qershorit 2023 të Presidentes së Republikës së Kosovës.
10. Më 5 shkurt 2024, znj. Saranda Bogujevci, deputete e Kuvendit dorëzoi komentet ndaj kërkesës së Avokatit të Popullit në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!
 11. Më 6 shkurt 2024, z. Abelard Tahiri, deputet i Kuvendit, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi nga Gjykata afat shtesë për dorëzim të komenteve lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit.
 12. Më 7 shkurt 2024, Gjykata njoftoi z. Abelard Tahirin për miratim të kërkesës për afat shtesë deri më 15 shkurt 2024.
 13. Më 8 shkurt 2024, Gjykata njoftoi: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës; (ii) Kryetarin e Kuvendit; (iii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës; dhe (iv) KQZ-në, për pranimin e komenteve nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! me mundësi të dorëzimit të përgjigjeve ndaj këtyre komenteve, nëse kanë deri më 15 shkurt

- 2024 dhe për miratimin e Gjykatës për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve deri më 15 shkurt 2024 nga z. Abelard Tahiri.
14. Më 12 shkurt 2024, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! dorëzoi dokumente shtesë lidhur me kërkesën.
 15. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
 16. Më 25 korrik 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe vendosi që kërkesa ka nevojë për shqyrtim të mëtutjeshëm në një seancë të ardhshme.
 17. Më 26 nëntor 2024, Gjyqtarja raportuese Kolegjit shqyrtues përmes Raportit paraprak i rekomandoi papranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësimin e saj në merita dhe Gjykata votoi me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër që kërkesa është e pranueshme.
 18. Më 19 dhjetor 2024, Gjykata, njëzëri, vendosi që neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk është në kundërshtim me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përmbledhje e fakteve

19. Më 19 prill 2023, z. Abelard Tahiri, në emër të deputetëve nënshkrues të Kuvendit bazuar në nenin 79 [Nisma Legjislative] të Kushtetutës, nenin 5 (E drejta e nismës legjislative) të Ligjit nr. 04/L-025 për Nisma Legjislative dhe pikës 3 të paragrafit 1 të nenit 70 (Propozimi i projektligjit) të Rregullores së Kuvendit, i propozuan Kuvendit Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
20. Më 12 maj 2023, Kryetari i Kuvendit ua dërgoi Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të gjithë deputetëve të Kuvendit.
21. Më 16 maj 2023, Komisioni Funkcional për Legjislacion i rekomandoi Kuvendit miratimin në parim të Projektligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Shqyrtimi i parë

22. Më 8 qershor 2023, Kuvendi bazuar në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit përmes Vendimit [Nr.08-V-539] vendosi që shqyrtimi i Projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të bëhet me procedurë të përshpejtuar.
23. Të njëjtën datë, në ora 10: 00, Kuvendi me tetëdhjetë e gjashtë (86 vota) për, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi, në parim, Projektligjin nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Shqyrtimi i dytë, miratimi, dekretimi dhe hyrja në fuqi

24. Më 8 qershor 2023, Komisioni Funkcional për Legjislacion dorëzoi raportin me njëzet (20) amendamente të propozuara për Projektligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

25. Më 8 qershor 2023, në ora 16:30, Kuvendi pas shqyrtimit të dytë, me Vendimin [Nr.08-V-562] e miratoi Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës me shtatëdhjetë e nëntë (79) vota për, tre (3) vota kundër dhe zero (0) abstenime.
26. Më 19 qershor 2023, Kuvendi e procedoi Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës te Presidentja e Republikës së Kosovës për dekretim dhe shpallje.
27. Më 3 korrik 2023, Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës u publikua në Gazetën Zyrtare. Neni 129 (Hyrja në fuqi) përcakton që: *“Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*.
28. Më 18 korrik 2023, Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës hyri në fuqi.

Pretendimet e parashtresit të kërkesës

29. Avokati i Popullit konsideron se neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.
30. Avokati i Popullit thekson: *“[...] e vlerëson se miratimi i ligjit të kontestuar në procedurë të përshpejtuar nuk është në pajtim me parimet e sundimit të ligjit, përkatësisht transparencën, ndërsa përcaktimi i kuotës gjinore prej 30% në ligjin e kontestuar nuk është në pajtim me vlerat kushtetuese në kuptimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin.”*
31. Bazuar në këtë, Avokati i Popullit konteston miratimin e Ligjit të kontestuar me procedurë të përshpejtuar, përkatësisht shmangies së miratimit të ligjeve nga afatet procedurale të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.

(i) Pretendimet në lidhje me procedurën e miratimit të Ligjit të kontestuar

32. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është miratuar nga Kuvendi me procedurë të përshpejtuar bazuar në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit çka ka pamundësuar “pjesëmarrjen aktive” të tij për ofrimin e komenteve lidhur me Ligjin e kontestuar. Sipas Avokatit të Popullit miratimi i ligjeve duhet të jetë transparent, i përgjegjshëm dhe demokratik, elementë këto të ligjshmërisë dhe parimit të sundimit të ligjit.

(ii) Pretendimet në lidhje me nenin 28 të Ligjit të kontestuar

33. Avokati i Popullit në mënyrë specifike pretendon se (i) vendosja me ligj e kuotës prej 30% për secilën gjini përbën paragjykim të pajustificuar, duke marrë parasysh se përqindja gjinore është pothuajse 50% me 50% burra dhe gra; (ii) në praktikën zgjedhore nuk ka ngjarë që subjektet politike të kenë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me nga 50% burra dhe gra; (iii) kriteri prej 30 % burra dhe gra i përcaktuar me nenin 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit të kontestuar veçsa e përligj trajtimin e pabarabartë sepse subjektet politike e plotësojnë kriterin ligjor për të garuar në zgjedhje duke dërguar listën e kandidatëve me nga 30% gra në listat zgjedhore; dhe, se (iv) neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit të kontestuar që përcakton pragun minimal prej 30% po ashtu është në kundërshtim me frymën e barazisë gjinore të mishëruar në nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 5 (Masat e përgjithshme për parandalimin e

diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore) të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

34. Së pari, Avokati i Popullit thekson: “Sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore: “Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor [...]”. Për më tepër, barazia gjinore garantohet me Kushtetutë dhe sigurohet si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë (Neni 7.2 i Kushtetutës).”
35. Në vijim të kësaj, Avokati i Popullit specifikon: “Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 28, paragrafi 1, përcakton se në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidateve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.’ Ndërsa, paragrafi 2 përcakton se ‘kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.’ Avokati i Popullit e vëren se ky formulim në paragrafin 1 dhe paragrafin 2 nuk dallon nga Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, tanimë i shfuqizuar me ligjin e kontestuar. E vetmja risi në këtë nen është e përfshirë në paragrafin 3, i cili përcakton se KQZ ‘ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një për qind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë për qind (30%) në momentin e certifikimit. KQZ-ja planifikon pas çdo palë zgjedhje buxhet shtesë për këtë qëllim.”
36. Në ndërlidhje me çështjen e lartcekur, Avokati i Popullit thekson: “[...] vendosja me ligj e kuotës (së paku 30%) për secilën gjini paraqet një lloj paragjykimi të pajustificuar, duke marrë parasysh se përqindja gjinore në mes të gjinive është pothuajse 50% me 50%, me dallime të vogla. Avokati i Popullit bazohet në të dhënat e World Population Prospects të vitit 2022, sipas të cilave përqindja në nivelin botëror në mes të gjinive është 50.3% për meshkuj dhe 49.7% për femra. Po ashtu, referencë i është bërë edhe të dhënave të EUROSTAT-it, sipas të cilave në Bashkimin Europian ka pothuajse 5% më shumë gra se burra. Më 1 janar 2022, në BE kishte 228 milionë gra dhe 218 milionë burra. Kjo korrespondon me një raport prej 104.6 gra për 100 burra, që do të thotë se ka pasur 4.6% më shumë gra se burra. Ndërsa, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë të vitit 2011, raporti gjinor rezulton të jetë 50.34% meshkuj dhe 49.66% femra. Vërehet se trendi i përqindjes në mes të meshkujve dhe femrave është pothuajse i barabartë, andaj vendosja e kuotës prej 30%, siç është bërë në ligjin e shfuqizuar e po ashtu edhe në ligjin e kontestuar është në kundërshtim me barazinë para ligjit praktikisht dhe me ligj, për nga aspekti i barazisë gjinore.”
37. Në vijim të pretendimeve të lartcekura, Avokati i Popullit i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GjEDNJ), përkatësisht rastit *Dakir kundër Belgjikës* (kërkesa nr.4619/12, Aktgjykim 11 korrikut 2017, paragrafi 65), përmes të cilit GjEDNJ: “[...] e rithekson se një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekte paragjyquese joproportionale ndaj një grupi individësh mund të konsiderohet si diskriminuese edhe nëse nuk e synon në mënyrë specifike grupin dhe nuk ka qëllim diskriminues. Megjithatë, ky është vetëm rasti nëse një politikë ose masë e tillë nuk ka justifikim “objektiv dhe të arsyeshëm”, domethënë nëse nuk ndjek një “qëllim legjitim” ose nëse nuk ka një “marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti” ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që kërkohet të arrihet” dhe rastit *S.A.S. kundër Francës*, kërkesa nr. 43835/11, Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafi 161.
38. Së dyti, Avokati i Popullit vlerëson: “Përcaktimi i kuotës (së paku 30%) për secilën gjini, në dukje nuk paraqet trajtim të pabarabartë në mes meshkujve dhe femrave,

megjithatë në praktikë nuk ka pasur raste kur subjektet politike i kanë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me 50% femra dhe 50% meshkuj. Vendosija e kriterit prej 30% e përligj trajtimin e pabarabartë sepse subjektet politike e plotësojnë kriterin ligjor për të garantuar në zgjedhje me dërgimin e listës së kandidatëve me 30% femra në listat zgjedhore, ndërsa pjesa tjetër u lihet në vullnetin e tyre, rrjedhimisht në praktikë femrat në vazhdimësi mbeten të nën-përfaqësuar.

39. Në vijim të kësaj, Avokati i Popullit specifikon: “[...] shumica e listave të subjekteve politike që kanë garantuar në zgjedhjet e përgjithshme të 14 shkurtit 2021, kanë qenë të përfaqësuar me 30% femra dhe me 70% meshkuj, ku edhe atëherë kriter ligjor për kuotën gjinore ka qenë që në listat e subjekteve politike secila gjini të jetë e përfaqësuar me jo më pak se 30%. Në praktikë vërehet se femrat kanë qenë të përfaqësuar me 30% ndërsa meshkujt me 70%. Ndërsa, është vërejtur se pothuajse në të gjitha listat me kandidatët e subjekteve politike çdo i treti kandidat ka qenë grua, ndërsa dy kandidatët e parë kanë qenë burra.” Sipas tij: “[...]një përcaktim i tillë ligjor prej së paku 30% (neni 28), nuk e promovon barazinë para ligjit, ndërsa në praktikë ka rezultuar se ua ka pamundësuar femrave që të jenë prezente në listat zgjedhore me pjesëmarrje të barabartë me meshkujt.”
40. Së treti, Avokati i Popullit konsideron: “Duke e pasur parasysh definicionin në paragrafin 1, të nenit 28, me të cilin përcaktohet pragu minimal prej 30%, vërehet se kjo dispozitë është në kundërshtim me frymën e barazisë në mes të gjinive dhe në kundërshtim me Ligjin për Barazinë Gjinore, neni 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, sipas të cilit përcaktohet: ‘1. Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislative dhe masat tjera duke përfshirë: 1.3. përfshirjen e integritimit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion’.”
41. Në vijim të kësaj, Avokati i Popullit specifikon: “[...] duke marrë parasysh se Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë shqyrtimit dhe miratimit të ligjit të kontestuar, nuk i ka marrë parasysh obligimet që rrjedhin nga Ligji për Barazi Gjinore, si ligj special në lidhje me barazinë gjinore, e konsideron se në këtë rast janë shkelur dispozitat kushtetuese lidhur me barazinë para ligjit.”
42. Avokati i Popullit duke iu referuar Kodit Elektorale të Belgjikës, përkatësisht nenit 117 bis të duke specifikuar se “si një shembull model i përfshirjes së integritimit gjinor në legjislacion, sipas të cilit: “[...] diferenca ndërmjet të gjithë kandidatëve të secilës gjini brenda së njëjtës liste nuk mund të jetë më e madhe se një. Për më tepër, i njëjti nen e përcakton se dy kandidatët e parë në lista zgjedhore nuk mund të jenë të gjinisë së njëjtë.”
43. Së katërti, Avokati i Popullit thekson: “[...] paragrafi 3 i nenit 28 të Ligjit të kontestuar mund të shihet si masë e veçantë për të arritur barazinë gjinore, mirëpo kuota (së paku 30%), e përcaktuar për listat e kandidatëve të subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, mbetet kontestuese për faktin se cenon barazinë para ligjit dhe në rastin konkret paraqet diskriminim të tërthortë.”
44. Në kuptim të kufizimit të drejtave dhe lirive themelore, Avokati i Popullit thekson se të drejtat dhe liritë themelore mund të kufizohen vetëm në kuptim të nenit 55 të Kushtetutës dhe në vijim të kësaj i referohet rastit të Gjykatës KO131/12, me parashtrues Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 15 marsit 2013.

45. Në lidhje me këtë të fundit, Avokati i Popullit specifikon: “[...] megjithëse kuota e përcaktuar në ligjin e kontestuar nuk paraqet kufizim të drejtës, paraqitja e saj si limit minimal i pjesëmarrjes në rastin konkret nuk është proporcionale dhe nuk pasqyron barazinë gjinore, dhe si e tillë nuk është në përputhje as me parimin mos-diskriminimit. Gjithashtu, një vendosje e tillë është në kundërshtim me qëllimin legjitim të ndjekur për arritjen e barazisë gjinore, siç kërkohet me Kushtetutë ‘Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore. Përveç kësaj një përcaktim i tillë e cenon esencën e të drejtës së garantuar, që në rastin konkret është e drejta për t’u zgjedhur, e drejta e pjesëmarrjes dhe e drejta e barazisë para ligjit.”
46. Në fund, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që të vlerësojë nëse neni 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit të kontestuar është në pajtim me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, të dorëzuara në Gjykatë më 24 shkurt 2024

47. Bazuar në komentet e dorëzuara nga znj. Saranda Bogujevci, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! ndaj kërkesës së Avokatit të Popullit, të njëjtat ndërlidhen me (i) pretendimet e Avokatit të Popullit për procedurën e miratimit të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) pretendimeve përkitazi me kushtetutshmërinë e nenit 28 të Ligjit të kontestuar.
48. Së pari, përkitazi me miratimin dhe publikimin e Ligjit të kontestuar, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! theksoi: “Në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Kuvendi i Kosovës vendosi shkurtimin e afateve për secilën fazë, duke nisur nga afati për dorëzimin e amandamenteve, shqyrtimin e projektligjit dhe amandamenteve nga Komisioni përgjegjës-raportues, shqyrtimi i projektligjit dhe raportit me amendamente nga komisionet e përhershme, paraqitja e raportit me rekomandime nga Komisioni përgjegjës-raportues dhe shqyrtimin e dytë të projektligjit në seancë plenare. Pavarësisht nga sa u cek më lartë, çështjet procedurale të Kuvendit nuk janë çështje kushtetuese. Për këtë çështje janë një seri vendimesh të Gjykatës Kushtetuese që e qartësojnë se rregullimi dhe veprimet e brendshme të Kuvendit janë një çështje e vet Kuvendit. E mbi të gjitha deputetët kanë të drejtën e tyre të plotë kushtetuese që të vendosin për rendin e ditës të seancës së Kuvendit, radhën e afatet e shqyrtimit të projektligjeve.”
49. Së dyti, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! iu referua rasteve KI45/20 dhe KI46/20 (me parashtrues Tinka Kurti dhe Drita Millaku, Aktgjykim, i 26 marsit 2021) të Gjykatës, përmes të cilit në paragrafin 142 të tij është theksuar: “Gjykata gjithashtu sqaroi faktin se ndonëse neni 6.8 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh që: “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrës;”.
50. Sipas Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!: “Kuvendi si ligjvënës nuk e ka formuluar këtë përqindje si një kuotë obligative ligjore por e ka formuluar më tepër në formë të një ideali kushtetues, ligjor e faktik që shoqëria demokratike e Republikës së Kosovës duhet ta arrijë dhe se vetëm pas arritjes së saj sigurohet barazia e vërtetë

faktike. Pra, 50%-shi i normuar në nenin 6.8 të Ligjit për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm siç është 30%-shi i normuar në nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ku specifikisht paraqitet obligimi që: “Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra [...]”

51. Përkitazi me diskriminimin e tërthortë në kontekst të neneve 7 dhe 24 të Kushtetutës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! theksoi: “Pikërisht si rrjedhojë e paragrafit 3 të nenit 24 në lidhje me nenin 7 të Kushtetutës, Ligji me nenin e kontestuar përcakton kuotën minimale të përfshirjes gjinore në listat e kandidatëve të subjekteve politike, pa kufizuar në asnjë mënyrë mundësinë e tejkalimit të kuotës. Për më tepër, paragrafi 3 i nenit të kontestuar, jo vetëm se nuk përbën diskriminim të tërthortë, siç pretendon Parashtruesi, por ka pikërisht synim që krahas minimumit ligjor të përfshirjes gjinore në lista, të stimulojë përfshirjen dhe zgjedhjen e grave deputete përtej pragut prej 30%. Pretendimi i parashtruesit të kërkesës - Avokatit të Popullit, për më tepër konstatimi i përgjithësuar, se “paragrafi 3 i nenit 28 të Ligjit të kontestuar [...] mbetet kontestuese për faktin se e cenon barazinë para ligjit dhe në rastin konkret paraqet diskriminim të tërthortë.” pa ndonjë arsyetim apo interpretim të argumentuar, është i pabazuar, i padrejtë, i papërgjegjshëm, rrjedhimisht edhe i pavlefshëm.”
52. Përkitazi me hapësirën e vlerësimit të ligjvënësit në caktimin e kuotës gjinore, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! sërish i referohet paragrafit 42 të Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe KI 46/20 të Gjykatës përmes të cilit ishte vlerësuar: “Ndonëse ideali kushtetues dhe fryma e Kushtetutës e reflektuar në nenin 7 synojnë arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive, Gjykata Kushtetuese është e vetëdijshme që nuk është në kompetencën e saj që të caktojë politika të reja publike e as të vlerësojë nëse një politikë publike e deritashme është e mirë apo e duhur. Gjithashtu, nuk i takon Gjykatës që të rivendosë kuota të reja ligjore ose të rrisë për qindjen e kuotave ligjore të përfaqësimit gjinor në favor të asnjërës gjini. Ligjvënësit e Republikës së Kosovës janë ata që kanë vendosur kuotën prej 30% si kuotë të vetme ligjore të aplikueshme, e cila duhet të ruhet në çdo rrethanë përderisa autoritetet kompetente nuk vendosim që të bëjnë ndryshime ligjore në këtë aspekt, nëse ato e shohin të nevojshme. Janë gjithashtu ligjvënësit ata që kanë caktuar 50%-shin si ideal kushtetues të përfaqësimit të barabartë gjinor duke theksuar se përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet vetëm kur sigurohet përfaqësim 50-50 për secilën gjini.”
53. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se kuota gjinore duhet të caktohet në 50% për të dy gjinitë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! kundërgjykon: “Së pari, kuota maksimale 50-50 për listat zgjedhore, siç kërkohet nga Parashtruesi, është një ekstrem që ndodhet jashtë normës evropiane dhe, së dyti, kuota 30%, siç parashihet në Ligjin me nenin e kontestuar, është në përputhje të plotë me mesataren e shteteve të Evropës. Për më tepër, duhet të theksohet se, sipas përvojës evropiane, megjithëse kuotat gjinore janë një mjet efektiv për rritjen e pranisë së grave në organet politike, ato nuk rezultojnë automatikisht në një përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave. Kuotat gjinore synojnë të përmirësojnë ekuilibrin gjinor në politikë. Ato përcaktojnë për qindjet minimale të kandidatëve gra për zgjedhje, zakonisht në listat e partive. Pra, për rritje të efikasitetit të zbatimit të kuotës gjinore, mund të ketë edhe dispozita për renditjen në listë. Ky veprim është pjesë e Ligjit me nenin e kontestuar. Edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20, thekson se: Qëllimi i vendosjes së kuotave, siç do të tregojë edhe analiza e mëtejme, ndër lidhet me nevojën për avancimin e barazisë gjinore brenda një shoqërie deri në arritjen e një barazie faktike kur kuotat bëhen të panevojshme. Parashtruesi, sado që mund të mos mjaftohet me garancinë minimale

- prej 30% për secilën gjini dhe, kjo është legjitime në rrafshin e përgjithshëm të angazhimit drejt idealit për barazi të plotë gjinore, ai nuk ofron asnjë argument kushtetues e as ligjor, madje as teorik, të besueshëm, se si përcaktimi i kuotës minimale qenka pengesë për arritjen të përfaqësimit ideal të barazisë gjinore.”*
54. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se neni 28 i Ligjit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës nuk mund të kuptohet i izoluar por duhet kuptuar në ndërvarësi me paragrafin 6 të nenit 111 (Ndarja e vendeve) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në këtë kontekst shton: *“Marrë parasysh këtë, neni i kontestuar 28 i Ligjit të kontestuar, paragrafi 1, nuk mund të shihet si dispozitë e izoluar, përkundrazi është dispozitë e ndërvarur me nenin 111, paragrafi 6 të Ligjit me nenin e kontestuar. Megjithkëtë, Parashtruesi duke e trajtuar nenin e kontestuar, paragrafin 1 si të pa ndërlidhur me nenin 111 paragrafi 6 të Ligjit, me ose pa vetëdije, shtrembëron thelbin e përmbajtjes së rregullimit ligjor të kuotës gjinore për Kuvendin e Kosovës. Për më tepër, përveçse pa ofruar asnjë argument relevant se si kuota gjinore e dëmton gjininë e nënpërfaqësuar, nga Kërkesa nuk del krejt i qartë edhe qëllimi i Parashtruesit. Nuk është e qartë pse kontestohet kuota minimale prej 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në njërën anë, parashtruesi nuk sqaron se si mund të zbatohet kjo kuota minimale e përfaqësimit gjinor, e përcaktuar në nenin 111, paragrafi 6 pa nenin e kontestuar, paragrafi 1. Në anën tjetër, Parashtruesi nuk sqaron kundërshtinë logjike, që nëse përcaktimi minimal i kuotës gjinore prej 30% për secilën gjini në nenin e kontestuar, paragrafi 1 qenka në kundërshtim me Kushtetutën, si nuk qenka atëherë në kundërshtim me po këtë Kushtetutë edhe rregullimi në përmbajtje dhe me qëllim të njëjtë, i përcaktuar në nenin 111, paragrafi 6 të Ligjit.”*
55. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! duke iu referuar paragrafëve 142 dhe 143 të Aktgjykimit të rasteve të Gjykatës KI45/20 dhe KI46/20, vë në spikamë konstatimin e kësaj të fundit lidhur me karakterin e kuotës minimale prej 50% të parashikuar me ligjin për barazi gjinore: *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrës. “. Kuvendi si ligjvënës qartësisht nuk e ka formuluar këtë përqindje si një kuota obligative ligjore por, e ka formuluar në formë të një ideali ligjor, në kuptimin normativ të synimeve ideale, që shoqëria demokratike e Republikës së Kosovës duhet ta arrijë dhe se vetëm pas arritjes së saj sigurohet barazia e vërtetë faktike. Pra, 50%-shi i normuar në nenin 6.8 të Ligjit për Barazi Gjinore, nuk është një kuota ligjore për përfaqësim të detyrueshëm, siç është 30%-shi i normuar në nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (lexo, tani neni 28), ku shprehimisht përcaktohet obligimi, që: “Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) përqind janë femra [...]”*
56. Në këtë kontekst, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! shton: *“Nga të lartëcekurat në këtë shkresë, qartazi shihet se pretendimi i Parashtruesit se neni i kontestuar 28 i Ligjit është kundërshtues, është krejtësisht i pabazuar. Përkundrazi, ky nen përbën kusht të domosdoshëm për zbatimin e nenit 111, paragrafi 1, për ndarjen e vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke garantuar minimumin e përfaqësimit prej 30% të secilës gjini. Nëse Parashtruesi pretendon se kufizimi minimal prej 30% për secilën gjini është i pamjaftueshëm, atëherë kjo nuk përbën çështje kushtetuese, sepse bie në fushëveprimin e hartimit dhe dizajnit të politikave publike.”*
57. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! pretendon se parashtruesi i kërkesës ka “keqkuptuar” kuotën gjinore prej 30% dhe thekson: *“Parashtruesi në mënyrë të pabazuar dhe krejtësisht paragjyquese, konstaton në fakt se 30% nuk është minimumi por maksimumi i lejuar. Me fjalë tjera, Parashtruesi parasheh, mbi bazën e sjelljeve të*

mëhershme të subjekteve politike dhe mbi bazën e një ligji të shfuqizuar, se minimumi i përfaqësimit 30% të grave, si dispozitë ligjore afirmative për përfshirje në listat zgjedhore, do të jetë përfaqësimi maksimal në këto lista. Sipas parashtruesit, minimumi prej 30% është maksimumi i përfshirjes së grave në listat zgjedhore. Pra, neni i kontestuar i Ligjit përmbush plotësisht premisat e nenit 24, paragrafi 3 të Kushtetutës, për faktin se 30%, si prag minimal është dispozitë afirmuese, paraqet masën me kuptimplotë për të ardhur deri të përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave në listat zgjedhore dhe në Kuvend të Kosovës. (Shih paragrafët 54 dhe 57, në lidhje me paragrafët 3, 26 dhe 40 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KO13/15 i vitit 2015).”

58. Në këtë kuptim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! më tej pretendon: “Ajo që mund të argumentohet me saktësi është se, pragu minimal nuk ndalon, po përkundrazi, nxit partitë që niveli i përfaqësimit të grave në listat zgjedhore edhe në Kuvend të rritet, sipas kushteve dhe mundësisë që i ofrojnë faktorët demografik, social, ekonomik dhe politik të një vendi. Prandaj, Parashtruesi, në aspektin argumentativ, ka dështuar të sqarojë se pse neni i kontestuar i Ligjit është në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit dhe me ndonjë “situatë të rëndë të diskriminimit” (shih paragrafin 61, Rasti KO 13/15 të Gjykatës Kushtetuese).”
59. Në kontekst të barazisë para ligjit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson: “Një aspekt tjetër i përmbushjes së premisave të nenit 24 të Kushtetutës, përcaktohet te ndalimi i kufizimit të pragut maksimal të përfaqësimit gjinor të burrave dhe të grave. Andaj, gratë, sipas legjislacionit në fuqi, kanë të drejtën e plotë të gjejnë përfaqësimin e tyre në listat zgjedhore edhe në Kuvend, duke filluar nga pragu minimal 30% e më shumë. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese në rastin KO13/15, paragrafi 59, e afirmon këtë parim, duke theksuar se “Gjithashtu, Këshilli Kushtetues i Francës, në një vendim të vitit 1982, refuzoi si jokushtetues një propozim për të kufizuar përqindjen maksimale të cilësdo gjini në listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale në 75%. Këshilli konsideroi se kuotat binin ndesh me parimet kushtetuese të barazisë dhe të universalitetit që ndalonin çdo ndarje në kategori të zgjedhësve dhe të personave që do të zgjidhen.
60. Përkritazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! replikon: “Neni 55 i Kushtetutës përcakton drejtë dhe saktë, se nuk mund të bëhet fjalë për proporcionalitetin pa kufizim. Pra, kusht për të ardhur në shprehje parimi i proporcionalitetit, duhet të ekzistojë kufizimi i një lirie apo të drejte themelore. Parashtruesi thekson se kuota gjinore nuk paraqet kufizim por është jopropocionale, ndërsa neni 55 thekson se kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore mund të bëhet me ligj, por duhet të jetë proporcional. Pra, parimi i proporcionalitetit ekzistencën e vet e gjen te kufizimi.”
61. Përkritazi me nenin 45 të Kushtetutës në kontekst të kuotës gjinore 30%, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson: “Kuota Gjinore prej 30% si prag minimal nuk është kriter që cenon të drejtën për t’u zgjedhur as sipas Kushtetutës, e as sipas nenit të kontestuar të Ligjit. Përkundrazi, neni i kontestuar, si dispozitë afirmative, lehtëson edhe më tej të drejtën për t’u zgjedhur për gratë në organet përfaqësuese. Në këtë mënyrë përmbushen premisat e nenit 45 të Kushtetutës, ku garantohet kushtetushmërisht dhe ligjërish e drejta për t’u zgjedhur dhe garantimi i pragut minimal si masë afirmative, që kuptimëson dhe harmonizon plotësisht nenin e kontestuar me nenin 45 të Kushtetutës. Pra, në asnjë nen të Ligjit, përfshirë nenin e kontestuar, nuk parasheh asnjë kufizim për kandidimin e grave në listat zgjedhore të partive politike. Madje, në paragrafin 1 të nenit të kontestuar, përveç përcaktimit të kuotës së përfaqësimit prej minimum 30% për secilën gjini, shprehimisht ka përcaktuar

edhe mënyrën e radhitjes së kandidatëve në listat e kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale.”

62. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! pohon se Kushtetuta por as marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të parashikuara në nenin 22 të Kushtetutës nuk përcaktojnë kuotë gjinore dhe shton: *“Konventat e paraqitura në Nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk përfshijnë në asnjë nen apo në ndonjë protokoll shtesë, moslejimin e kuotës minimale gjinore, e aq më pak të kuotës 30%. Sikurse në të njëjtat nuk përcaktohet as kuota maksimale në rastet e listave zgjedhore apo në çfarëdo rasti tjetër. Madje në to nuk ka asnjë dispozitë që nxit shtetet anëtare të vendosin kuota maksimale gjinore në listat zgjedhore. Prandaj dhe Kushtetuta e Kosovës, e hartuar në bashkëkohësi, që garanton barazinë gjinore, nuk ka përfshirë në asnjë dispozitë përcaktimin e kuotës gjinore as minimale as maksimale. Ngase është gjerësisht e ditur dhe pranuar se ideali i barazisë ndihmohet por nuk garantohet nga kuota. Në këtë kuptim, edhe Gjykata Kushtetuese, në rastin KO13/15, paragrafi 45 dhe 53 thekson se “Garancitë e lartpërmendura kushtetuese të barazisë gjinore janë në linjë me shumë kushtetuta të vendeve demokratike dhe me instrumente e rekomandime ndërkombëtare dhe, siç shihet nga referencat e lartpërmendura, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në mënyrë të barabartë përmban garancitë e njohura ndërkombëtarisht për barazinë gjinore.”*
63. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës në përgjithësi, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! pohon: *“Pra, nëse do të ndiqej logjika e Parashtruesit, pra, nëse ndiqet i njëjti parim, sipas kërkesës së Parashtruesit, mosdiskriminimi konkret, sipas kuptimit të Parashtruesit, do të duhej të pasohej me zgjedhjen e përfaqësuesve të dy gjinive 50% me 50%, për çdo post dhe për çdo institucion në Republikën e Kosovës, tani dhe menjëherë. Por parashtruesi nuk është duke shtruar pyetje për organet e tjera publike por vetëm për partitë politike dhe listat e tyre zgjedhore. Këto pyetje të Parashtruesit nuk kanë të bëjnë me përfaqësimin në Kuvend, por me listat e partive politike. Sepse rezultati zgjedhor, pavarësisht çfarë kuote vendoset, varet nga vota popullore, që është edhe instanca kushtetuese që vendos se sa gra e sa burra do t'i dërgojë në Kuvend.”*
64. Në fund, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! konkludon: (i) konsiderojmë që pyetjet dhe pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara; (ii) neni 28 i kontestuar i Ligjit Nr. 08/L - 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i kontestuar nga Parashtruesi-Avokati i Popullit, është në përputhje me Kushtetutën.

I.DISPOZITAT RELEVANTE TË KUSHTETUTËS

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

*“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”*

Neni 7 [Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 45 **[Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]**

“1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”

II. Dispozitat relevante të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 21

“1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

2. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet.

3. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.”

PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Neni 25

“Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 14 (Ndalimi i diskriminimit)

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3 (E drejta për zgjedhje të lira)

“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”

III. Dispozitat relevante të legjislacionit në fuqi

LIGJI Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE

Neni 5 Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore

[...]

2. Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.”

Neni 6 Masat e veçanta

“1. Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimin të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi.

2. Masat e veçanta mund të përfshijnë:

2.1. kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve;

[...]

8. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”

Neni 13

Avokati i Popullit

“Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.”

LIGJI Nr. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Neni 6 Trajtimi i ndryshëm i përligjur

“Pavarësisht nga nenet 3 dhe 4 të këtij Ligji, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat e nenit një (1) të këtij Ligji, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.”

RREGULLORE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (E publikuar në Gazetën Zyrtare më 9 gusht 2022)

KREU XX TRANSPARENCA E KUVENDIT

Neni 123 Shmangia nga afatet procedurale

*“1. Me propozim të së paku gjashtë (6) deputetëve, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores.
2. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”*

IV. Dispozita e kontestuar dhe dispozitat relevante të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Neni 28 Kuotat gjinore

*“1. Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.
2. Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.
3. KQZ ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një për qind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë për qind (30 %) në momentin e certifikimit. KQZ-ja planifikon pas çdo palë zgjedhje buxhet shtesë për këtë qëllim.”*

Neni 111 Ndarja e vendeve

“[...]

4. Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit politik numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirënditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.
5. Vendet që i ndahen subjektit politik në paragrafin 2 të këtij neni u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirënditur të kandidatëve të subjektit politik në paragrafin 4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listë sipas një renditje zbritëse, deri në mbarim të vendeve që i ndahen subjektit politik pavarësisht numrit të votave të kandidatëve. Vendet shtesë që u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sikurse në paragrafin 3 të këtij neni u ndahen kandidatëve pasues nga lista e rirënditur nga paragrafi 4 i këtij neni e kandidatëve të subjektit politik.
6. Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku tridhjetë për qind (30%) nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirënditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku tridhjetë për qind (30%). Ky paragraf nuk zbatohet ndaj ndarjes së vendeve nga lista që përbëhet prej një (1) apo dy (2) kandidatëve.
7. Asnjë person që është anëtar i ndonjë organi tjetër ligjvënës të zgjedhur nuk mund të ketë vend në Kuvend. Një anëtar i Kuvendit që është ose bëhet anëtar i ndonjë organi tjetër ligjvënës të zgjedhur pas marrjes së vendit në Kuvend, humb mandatin e tij në Kuvend.
8. Një person që humb mandatin sipas këtij neni zëvendësohet në pajtim me dispozitatat nga neni 112 i këtij ligji.”

Neni 112 Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit

“1. Vendet e shpërndara në përputhje me këtë Ligj mbahen personalisht nga kandidatet e zgjedhur dhe jo nga subjekti politik. Mandati i anëtarit nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundojë mandati përveç në rastet vijuese:

- 1.1. dënimi i anëtarit për veprë penale për të cilën ai apo ajo është dënuar me burgim sikurse parashikohet me anë të nenit 70 paragrafit 3, nënparagrafit (6) të Kushtetutës;
 - 1.2. dështimi i anëtarit që të marrë pjesë në seancat e Kuvendit apo të Komisioneve për gjastë (6) muaj radhazi, anëtar i të cilave ai apo ajo janë, përveç nëse jepet ndonjë arsye bindëse në pajtim me Rregulloren e Kuvendit;
 - 1.3. humbja e mandatit të anëtarit, sipas nenit 30 të këtij ligji;
 - 1.4. vdekja e anëtarit;
 - 1.5. paaftësia mendore ose fizike e anëtarit, e përcaktuar me anë të vendimit përfundimtar gjyqësor, apo
 - 1.6. dorëheqja e anëtarit.
2. Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin me paragrafin 1 të këtij neni zëvendësohet si vijon:
- 2.1. Nga kandidati i ligjshëm në radhë, i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të subjektit politik, në emër të së cilës garoi anëtarit, nëse në një rast të tillë nuk cenohet garancia e përfaqësimit të detyrueshëm minimal të gjinisë së nënpërfaqësuar, në kuotën prej tridhjetë për qind (30%) të subjektit politik;
 - 2.2. Vetëm nëse nuk ka kandidatë tjerë të ligjshëm, pavarësisht votave të tij/saj në listën e kandidatëve, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të subjektit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111 paragrafi 4 të këtij ligji nga zgjedhjet e fundit të të njëjtit lloj; dhe

2.3. nëse anëtari është kandidat i pavarur, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të subjektit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111 paragrafi 4 të këtij ligji.

3. Pasi që një ulëse të mbetet e zbrazët, Kryetari i Kuvendit i bën kërkesë me shkrim Presidentit për mbushjen e ulëses së zbrazët. Një kërkesë e tillë duhet të përfshijë edhe sqarimin se pse u lirua kjo ulëse.

4. Pas pranimit të kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij neni, nëse sqarimi i dhënë është i 2 mjaftueshëm, Presidenti duhet të kërkojë nga KQZ-ja të rekomandojë emrin e personit për ta mbushur vendin e lirë. KQZ-ja duhet që në afatin prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i marrjes së kërkesës, t'ia ofrojë Presidentit emrin radhës së personit të ligjshëm sipas paragrafit të këtij neni.”

V. Dokumentet relevante të organizatave ndërkombëtare

A. Në nivel të Kombeve të Bashkuara

Rezoluta [1706 \(2010\)](#) për rritjen e përfaqësimit të grave në politikë përmes sistemit zgjedhor të miratuar nga Asambleja Parlamentare më 27 janar 2010;

Rezoluta [2111 \(2016\)](#) për vlerësimin e ndikimit e masave për të përmirësuar përfaqësimin politik të grave, miratuar nga Asambleja Parlamentare më 21 prill 2016;

Udhëzime për shtetet për zbatimin efektiv të së drejtës për të marrë pjesë në çështjet publike, Raporti i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 20 korrik 2018.

B. Në nivel të Këshillit të Evropës

(i) Rekomandimet

Rekomandimi Rec (2003) 3 “Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike”, i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 12 mars 2003 dhe Memorandumi i tij shpjegues

(ii) Opinionet dhe Raportet e Komisionit të Venecias

Kodi i Praktikës së Mirë i Çështjeve Zgjedhore, Udhëzime dhe Raporti Shpjegues [[CDL-AD \(2002\) 23 rev1](#)], i Komisionit të Venecias, dhe Raporti i tij Shpjegues, i miratuar më 5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002;

Raport mbi ndikimin e sistemeve zgjedhore në përfaqësimin e grave në politikë, i miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike më 14 mars 2009 dhe Komisioni i Venecias, më 12-13 qershor 2009;

Udhëzime [CDL-AD\(2010\)24](#) për rregullimin e partive politike i OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias, miratuar në seancën e 84-të plenare më 15-16 tetor 2010;

Raport mbi ligjin zgjedhor dhe administrimin e zgjedhjeve në Evropë [[CDL-AD\(2020\)023](#)], i miratuar nga Komisioni i Venecias më 8-9 tetor 2020.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

65. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

66. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës, të Ligjit dhe të Rregullores së punës, sipas të cilave Avokati i Popullit mund të paraqitet si parashtrues para kësaj Gjykate:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“[...]

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

[...].”

Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit]

“[...]

4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.”

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

Neni 29 (Saktësimi i kërkesës)

“1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.”

Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese

Rregulli 65 (Kërkesa në pajtim me nënparagrafët 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nënparagrafët (1) dhe (2) të paragrafit (2) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 29 (Saktësimi i kërkesës) dhe 30 (Afatet) të Ligjit.

(2) Kur parashtron një kërkesë në pajtim me paragrafin (2) të nenit 113 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, ndër të tjera, nëse përmbajtja e plotë ose pjesë të caktuara të aktit të kontestuar, konsideron të jenë në mospërputhshmëri me Kushtetutën.

(3) Pala e autorizuar duhet të paraqesë në kërkesë kundërshtimet lidhur me kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrohet brenda një periudhe prej gjashtë

(6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”

67. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë (i) nëse kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar, siç është përcaktuar në nënparagrafin (1) të paragrafit (2) të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 29 të Ligjit; (ii) natyrën e aktit të kontestuar; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet nëpërmjet paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit dhe nënregullit 2 dhe 3 të rregullit 65 të Rregullores së punës; dhe (iv) nëse kërkesa është dorëzuar brenda afatit gjashtë (6) mujor, pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar, siç është përcaktuar në nenin 30 të Ligjit dhe nënregullin 4 të Rregullit 65 të Rregullores së punës.

(i) *Lidhur me palën e autorizuar dhe aktin e kontestuar*

68. Avokati i Popullit bazuar në nenin 113.2 (1) të Kushtetutës është i autorizuar që para Gjykatës të ngrejë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të (i) ligjeve; (ii) dekreteve të Presidentit; (iii) dekreteve të Kryeministrit; dhe (iv) rregulloreve të Qeverisë. Neni 29 i Ligjit saktëson që Avokati i Popullit është palë e autorizuar para Gjykatës dhe rregulli 65 i Rregullores së punës thirret në nenet përkatëse të cituara më lart të Kushtetutës dhe Ligjit.

69. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se Avokati i Popullit në cilësi të parashtruesit të kërkesës, para Gjykatës konteston kushtetutshmërinë e nenit 28 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht një “ligj” të miratuar nga Kuvendi.

70. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se para saj është një kërkesë e dorëzuar nga Avokati i Popullit, i cili bazuar në nenet e lartcekura të Kushtetutës, të Ligjit dhe të Rregullores së punës, është palë e autorizuar që para Gjykatës, ndër të tjera, të paraqesë çështjen e përputhshmërisë së “ligjeve” me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit është palë e autorizuar dhe konteston një akt të cilin ka autorizim kushtetues që ta kontestojë.

(ii) *Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe specifikimin e kundërshtimeve*

71. Gjykata rikujton se neni 29 i Ligjit dhe rregulli 65 i Rregullores së punës përcaktojnë që kërkesa e ngritur në kontekst të nenit 113. 2 (1) të Kushtetutës të specifikojë (i) nëse i tërë akti i kontestuar ose pjesë të veçanta të këtij akti të konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) të specifikojë pretendimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

72. Gjykata vëren se Avokati i Popullit konteston kushtetutshmërinë e nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit të kontestuar me pretendimin se nuk është në përputhshme me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafi 1 i nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

73. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në procedurë para Gjykatës në mënyrë specifike ka kontestuar kushtetutshmërinë e nenit specifik të Ligjit të kontestuar.

(iii) *Lidhur me afatin*

74. Gjykata rikujton se neni 30 (Afatet) i Ligjit dhe rregulli 65 (4) i Rregullores së punës përcaktojnë se kërkesa e referuar në bazë të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës duhet të dorëzohet brenda afatit gjashtë (6) mujor pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.
75. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ka hyrë në fuqi më 18 korrik 2023, ndërsa është kontestuar në Gjykatë më 16 janar 2024, dhe rrjedhimisht, është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të parashikuar me dispozitat e lartpërmendura.

(iv) Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

76. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar; (ii) konteston një ligj të Kuvendit; (iii) ka specifikuar se konteston kushtetutshmërinë e dispozitës specifike të Ligjit të kontestuar; (iv) ka paraqitur pretendimet kundrejt dispozitës specifike të Ligjit të kontestuar; (v) ka dorëzuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë të dispozitës specifike të Ligjit të kontestuar brenda afatit të përcaktuar me Ligj.
77. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

I. HYRJE

78. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Avokati i Popullit, në kërkesën e tij (i) konteston procedurën e miratimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht procedurën e shmangies nga Rregullorja e Kuvendit, ashtu siç përcaktohet me nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të kësaj rregulloreje dhe (ii) konteston kushtetutshmërinë e nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Më saktësisht, Avokati i Popullit pretendon se neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.
79. Në lidhje me të parën, Gjykata rikujton që Avokati i Popullit thekson që Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është miratuar nga Kuvendi me procedurë të përsheptuar ashtu siç përcaktohet me nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit çka i ka pamundësuar atij "*pjesëmarrjen aktive*" për ofrimin e komenteve lidhur me këtë ligj. Sipas Avokatit të Popullit miratimi i ligjeve duhet të jetë transparent, i përgjegjshëm dhe demokratik, elementë këto të "*ligjshmërisë*" dhe "*parimit të sundimit të ligjit*".
80. Ndërsa në lidhje me kërkesën e tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Avokati i Popullit në thelb pretendon se neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, si dhe paragrafin 1 të nenit 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]. Në mënyrë specifike, Avokati i Popullit thekson se (i) vendosja me ligj e kuotës prej 30% për secilën gjini përbën paragjykim të pajustificuar; (ii) në praktikën zgjedhore nuk "*ka ngjarë që subjektet politike të kenë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me nga 50% femra dhe meshkuj*"; dhe, se (iii) neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që përcakton prapun minimal prej tridhjetë përqind (30%) po ashtu është në kundërshtim me frymën e barazisë gjinore të parashikuar me nën-paragrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 5 (Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor

dhe sigurimin e barazisë gjinore) të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Barazi Gjinore).

81. Pretendimet e mësipërme të Avokatit të Popullit kundërrargumentohen nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, i cili, në kuptim të procedurës së miratimit të Ligjit për Zgjedhje specifikon se procedura e miratimit të Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme është e bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, dhe e njëjta nuk ngre çështje kushtetuese, përderisa në kuptim të pretendimit të Avokatit të Popullit për mospërputhshmërinë e nenit 28 me Kushtetutën, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! specifikon se (i) pretendimet e Avokatit të Popullit janë të pabazuara; dhe se (ii) neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në përputhje me Kushtetutën, në esencë, sepse kjo dispozitë përcakton kuotë ligjore të përfaqësimit në lista zgjedhore. Në kuptim të kësaj të fundit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! specifikon se caktimi i kuotës prej 30% në listat zgjedhore (i) është kuotë ligjore, përderisa përcaktime të Ligjit për Barazinë Gjinore janë ideal kushtetues; (ii) nuk përbën diskriminim të tërthortë, për shkak se ky prag minimal është masë afirmative; (iii) ka për qëllim ruajtjen e ekuilibrit gjinor në politikë; (iv) dhe nuk cenon të drejtën për të zgjedhur, të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës.
82. Në lidhje me pretendimin e Avokatit të Popullit që ndërlidhet me kërkesën e tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, Gjykata vë në pah se thelbi i çështjes së ngritur nga Avokati i Popullit i referohet aspektit të përcaktimit të kuotës minimale prej 30% në listat zgjedhore. Thënë këtë, ky përcaktim në nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si masë afirmative ndërlidhet me parimet e përcaktuara me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe “*të drejtën për t’u zgjedhur*” të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

II. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me procedurën e miratimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

83. Gjykata vëren se Kuvendi, më 8 qershor 2023, mbështetur në paragrafin 1 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit, përmes Vendimit (Nr.-08-V-539) përcaktoi:

“1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bëhet me procedurë të përshpejtuar-shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 34 paragrafi 4, nenin 52 paragrafi 1 dhe nenin 76, paragrafët 3 dhe 8 të Rregullores së Kuvendit.”

84. Rregullorja e Kuvendit, në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedural) të saj, përcakton që me propozim të së paku gjashtë (6) deputetëve, Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e deputetëve të pranishëm për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores atëherë kur një vendimmarrje e tillë nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës. Bazuar në këtë dispozitë, është zhvilluar edhe procedura përmes të cilës është miratuar Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Më saktësisht, Gjykata rikujton që (i) nisma legjislative për miratimin e Projektligjit ishte ndërmarrë më 19 prill 2023; (ii) Projektligji iu ishte shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 12 maj 2023; (iii) më 16 maj 2023, Komisioni Funkcional për Legjislacion i rekomandoi Kuvendit miratimin në parim të Projektligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; (iv) Kuvendi kishte miratuar Ligjin e kontestuar në lexim të parë më 8 qershor 2023; (v) para procedurës së leximit të dytë, përkatësisht më 8 qershor 2023, Kuvendi, bazuar në nenin 123 të Rregullores së punës, kishte vendosur të shmangej nga afatet procedurale të Rregullores

së punës; (vi) raporti i Komisionit funksional i Kuvendit, i 8 qershorit 2023, përmbante njëzet (20) amendamente të propozuara për Projektligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ndërsa (vii) po të njëjtën ditë, në orën 16:30, më 8 qershor 2023 është mbajtur seanca plenare e Kuvendit, në të cilën ishte miratuar Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në procedurën e leximit të dytë.

85. Gjykata vëren që për shmangien nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, është i nevojshëm propozimi i vetëm gjashtë (6) deputetëve të Kuvendit dhe vota e 2/3 (dy të tretave) të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.
86. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që bazuar në nenin 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës, Rregullorja e punës së Kuvendit duhet të miratohet me 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa sipas të njëjtës Rregullore, shmangia nga çdo afat procedural i saj, i është mundësuar vetëm shumicës prej 2/3 (dy të tretave) të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Për më tepër, Gjykata vë në pah faktin që vetë deputetët e Kuvendit, përmes miratimit të Rregullores, kanë përcaktuar afate procedurale në kontekst të procesit të ligjberjes në Kuvend edhe në kontekst të rrethanave që ndërlidhen me (i) sigurinë kombëtare apo/edhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës. Gjykata vëren se përkundër edhe këtyre përcaktimeve, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, që ndërlidhet me zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës është nxjerrë në shmangie të të gjitha afateve procedurale në Kuvend.
87. Gjykata rikujton faktin që bazuar në Kushtetutë, përkatësisht nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të saj, ligjberja është një ndër funksionet më thelbësore të Kuvendit dhe ndër funksionet më esenciale të përfaqësuesve të popullit, përkatësisht deputetëve të Kuvendit (shih, në këtë kuptim rastin e Gjykatës [KO216/22 dhe KO220/22](#), parashtrues të kërkesës, *KO216/22, Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës; KO220/22, Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Aktgjykim i 2 gushtit 2023, paragrafi 210).*
88. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht vë në pah faktin që ushtrimi i pushtetit legjislativ është funksioni më thelbësor i Kuvendit siç është përcaktuar në nenet 4 [Forma e qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Këtë funksion i njëjti, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, e ushtron sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 79 [Nisma Legjislative] dhe nenin 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, ndërsa deputetët ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, siç është saktësuar në nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës. Për më tepër, Kushtetuta u përcakton rol të veçantë Komisioneve të Kuvendit, me theks, në procesin e ligjberjes. Më saktësisht dhe në këtë kontekst, e njëjta në nenin 77 [Komisionet] të saj, përcakton kategoritë e komisioneve, duke i klasifikuar në të përhershme, funksionale dhe *ad hoc*, duke vënë theks në rëndësinë e përbërjes së tyre, përfshirë rolin e komuniteteve jo-shumicë dhe duke deleguar rolin dhe procedurat përkatëse në nivel të Rregullores së Kuvendit. Rol të veçantë, Kushtetuta i përcakton Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në nenin 78 të tij, duke përcaktuar, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, edhe mundësinë që: (i) me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, që çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve; dhe (ii) kohën në dispozicion prej dy javësh që Komisioni të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar nëse zgjedh (shih, ndër tjerash, rastet nr. [KO216/22 dhe KO220/22](#), cituar më lart, paragrafi 204).

89. Përkundër faktit që vetë Rregullorja e Kuvendit përcakton shmangien nga afatet procedurale, vetëm në kontekst të rrethanave që ndërlidhen me sigurinë kombëtare/edhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, që ndërlidhet me zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës është nxjerrë në shmangie të të gjitha afateve procedurale në Kuvend. Megjithatë, Avokati i Popullit në kërkesën e tij vetëm nominalisht ngre pretendimin për procedurë të përshpejtuar për miratim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe në lidhje me këtë nuk specifikon dhe ofron argumentet përkatëse se si gjatë procedurës së miratimit të këtij ligji janë shkelur parimet e ligjshmërisë dhe sundimit të ligjit në këtë rast.
90. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë që procedura përkitazi me nxjerrjen e Ligjit të kontestuar, nuk është argumentuar të jetë në kundërshtim me *“parimin e ligjshmërisë, si një nga parimet parësore të sundimit të ligjit”*, siç pretendon parashtuesi i kërkesës, të garantuara edhe me nenin 7 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 65 të Kushtetutës.
91. Thënë këtë, Gjykata bazuar edhe në praktikën e saj gjyqësore që ndërlidhen me procedurën e miratimit të ligjeve në Kuvend, sërish rithekson që ushtrimi i pushtetit legjislativ, funksioni parësor i të cilit është procesi ligjvënës, nuk mund të reduktohet vazhdimisht në përcaktimet e nenit 123 të Rregullores së Kuvendit përmes të cilit 2/3 (dy të tretat) e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë mund të vendosin të anashkalojnë të gjitha afatet procedurale të së njëjtës Rregullore, duke përfshirë shqyrtimin e projektligjeve, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret dhe që përcaktojnë parimet thelbësore të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës e që nuk ndërlidhen as me ato rrethana në të cilat vetë Kuvendi, përmes Rregullores së tij, përjashtimisht ka përcaktuar *“procedurë të përshpejtuar”* apo/dhe *“procedurë urgjente”* të ligjbërjes në raste kur projektligjet përkatëse ndërlidhen ekskluzivisht me çështje të sigurisë kombëtare, shëndetit publik apo gjendjes së jashtëzakonshme. Gjykata në këtë kontekst rikujton nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, sipas të cilit, deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit (shih, rastet e Gjykatës [KO216/22](#) dhe [KO220/22](#), cituar më lart, paragrafi 214).

III. Përkitazi me kushtetutshmërinë e nenit 28 të Ligjit të kontestuar

A. Parime të përgjithshme

(i) Parimet e përgjithshme të Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës

92. Gjykata fillimisht i referohet nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, goftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”*
93. Në lidhje me të drejtat zgjedhore, Gjykata u referohet edhe Instrumenteve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i

Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës e që janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës (shih, në mes tjerash, rastin nr. [KO162/18](#), parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, paragrafi 36 dhe [KI207/19](#), parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, të cituar më lart, paragrafi 107).

94. Protokollin nr. 1 i KEDNj-së përmes nenit 3 (E drejta për Zgjedhje të Lira), ka përcaktuar: *“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”*
95. Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore ka theksuar se neni 45 i Kushtetutës përbëhet nga tre (3) paragrafë të veçantë dhe secili prej tyre ka elementet dhe rregullat përkatëse. Përkatësisht, paragrafi i parë i nenit 45 të Kushtetutës përcakton të drejtën për të zgjedhur (të drejtën aktive të votës), si dhe të drejtën për t'u zgjedhur (të drejtën pasive të votës). Në vijim, paragrafi i dytë i nenit 45 të Kushtetutës garanton që vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Për më tepër që të njëjtat janë në harmoni me pesë parimet themelore të trashëgimisë evropiane zgjedhore e të përmbledhura në Kodin e Praktikës së Mirë dhe në Raportin përkatës Shpjegues e të cilat, përfshijnë votën universale, të barabartë, të lirë, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë (shih, ndër tjerash rastin [KI69/21](#), parashtrues *Partia Liberale Egjiptiane (PLE) Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)*, Aktgjykim, i 20 prillit 2023, paragrafi 135).
96. Në vijim, Gjykata thekson se bazuar në përcaktimet kushtetuese, Republika e Kosovës është përcaktuar për një rend kushtetues në të cilin barazia gjinore përbën një nga vlerat themelore. Kjo vlerë ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe jetësimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore.
97. Në këtë kuptim, nevoja e krijimit të mundësive të barabarta krijon për shtetin detyrime pozitive për përdorim të instrumenteve dhe masave të ndryshme, duke përfshirë edhe normime ligjore, me qëllim të eliminimit të *“pabarazive faktike”* ndërmjet grave dhe burrave. Në kontekst të sigurimit të barazisë gjinore, me Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme është përcaktuar kuota gjinore e përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar në kuotën tridhjetë përqind (30%). Çështja e gjinisë së nënpërfaqësuar në legjislacionin e aplikueshëm quhet *“gjini pakicë”*, pa përcaktuar se cila gjini është ajo specifiku dhe kjo për faktin se në kohëra të ndryshme gjini pakicë mund të jetë njëra ose tjetra (shih, rastet e Gjykatës [KI45/20](#) dhe [KI46/20](#) parashtrues *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, Aktgjykim i 26 marsit 2021, paragrafi 74).
98. Gjykata në praktikën e saj gjyqësore ka vlerësuar se kuptimi i barazisë së synuar, e *“ka edhe dimensionin tjetër, përkatësisht diskriminimin pozitiv apo përcaktimin e kuotës gjinore për përfaqësim të gjinisë së nënpërfaqësuar, e cila konsiderohet të jetë në pajtueshmëri me frymën e idealeve kushtetuese dhe identitetit kushtetues të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimin të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues. Përfundimisht, koncepti i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit është dinamik dhe evoluon në drejtim të plotësimit të idealit sublim të barazisë në përfaqësim të grave dhe burrave në relacionin 50% me 50%.”* (shih, rastet e Gjykatës [KI45/20](#) dhe [KI46/20](#) parashtruese *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, cituar më lart, paragrafi 131).

99. Sipas nenit 45 të Kushtetutës, Gjykata nënvizon se kjo normë kushtetuese garanton të drejtën për të zgjedhur (aspektin aktiv të votës), si dhe të drejtën për t'u zgjedhur (aspektin pasiv të votës) (shih, me gjerësisht për këto dy aspekte, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku janë trajtuar çështje të ndryshme në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës: [KI01/18](#), me parashtrues *Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019; [KI48/18](#), me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019). Më specifikisht, aspekti pasiv i votës që reflektohet në të drejtën për t'u zgjedhur, paraqet një të drejtë specifike relevante në këtë rast konkret, i takon kandidatëve si individë, përkatësisht si persona fizikë, të cilët garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror, si dhe subjekteve politike, përkatësisht personave juridikë që garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror.
100. Në vijim, paragrafi 3 i nenit 45 të Kushtetutës përcakton: *“Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”*
101. Gjykata, gjithashtu rikujton që sipas praktikës së saj gjyqësore, në kuptim të të drejtave zgjedhore ka saktësuar: *“që kjo masë e përcaktuar në Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme, përkatësisht përcaktimi i përfaqësimit minimal të gjinisë pakicë 34 në minimum 30%, si e tillë është e domosdoshme në mënyrë që të mundësojë përfaqësimin edhe të gjinisë së nënpërfaqësuar në Kuvend, respektivisht grave. Si i tillë, ky përcaktim i ligjit për kuota gjinore, në parim nuk paraqet shkelje të të drejtave zgjedhore.”* (shih, paragrafin 134 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastet [KI45/20 dhe KI46/20](#), parashtruese *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, cituar më lart).
- (i) *Parimet e përgjithshme sipas dokumenteve ndërkombëtare në nivel të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës*
- a) *Në nivel të Kombeve të Bashkuara*
102. Neni 4 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) specifikon se: *“[një] Miratimi i masave të përkohshme të veçanta nga shtetet palë që synojnë përshpejtimin de facto të barazisë midis burrit dhe gruas, nuk konsiderohet diskriminim[...]”*.
103. Bazuar në Udhëzimet e nxjerra për shtetet për zbatimin efektiv të së drejtës për të marrë pjesë në çështjet publike përmes Raportit të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, është theksuar se shtetet duhet të zhvillojnë një kornizë ligjore efektive për ushtrimin e të drejtave zgjedhore, duke përfshirë në lidhje me sistemin zgjedhor dhe mekanizmat e kontesteve zgjedhore, në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përmes një procesi jo-diskriminues, transparent, të përgjegjshëm gjinor dhe pjesëmarrës. Shtetet duhet të marrin masa proaktive për të forcuar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe grupeve që janë të diskriminuara në proceset zgjedhore. Këto, ndër tjerash, mund të tregohen të nevojshme dhe të përshtatshme, dhe përfshijnë që Shtetet duhet të paraqesin dhe zbatojnë në mënyrë efektive sistemet e kuotave dhe vendet e rezervuara në organet e zgjedhura për gratë dhe grupet e nënpërfaqësuar, pas një vlerësimi të thellë të vlerës së mundshme të llojeve të ndryshme të masave të përkohshme të veçanta (shih, Udhëzimet për shtetet për zbatimin efektiv të së drejtës për të marrë pjesë në çështjet publike, Raporti i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 20 korrik 2018, paragrafi 31).

b) *Në nivel të Këshillit të Evropës*

104. Gjykata fillimisht vë në dukje, se instrumentet dhe dokumentet relevante përkritazi me përfaqësimin e barabartë në vendimmarrje politike dhe kuotat gjinore përfshijnë por nuk kufizohen në: (i) Rezolutën 1706 (2010) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, për rritjen e përfaqësimit të grave në politikë përmes sistemit zgjedhor të miratuar më 27 janar 2010; (ii) Rezolutën 2111 (2016) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vlerësimin e ndikimit e masave për të përmirësuar përfaqësimin politik të grave, miratuar më 21 prill 2016; (iii) Rekomandimin Rec (2003) 3, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, miratuar më 12 mars 2003 dhe memorandumi i tij shpjegues; (iv) Rekomandimin Rec 1899(2010) "*Rritja e përfaqësimit të grave në politikë nëpërmjet sistemit zgjedhor*", miratuar më 27 janar 2010; dhe (v) Kodin e Praktikës së Mirë të Çështjeve Zgjedhore [CDL-AD (2002) 23 rev]] i Komisionit të Venecias, i miratuar më 5-6 korrik dhe Raporti i tij Shpjegues, i miratuar më 18-19 tetor 2002.
105. Fillimisht Gjykata vëren se sipas Rezolutës 1706 (2010) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës "*ndryshimi i sistemit zgjedhor në një sistem më të favorshëm për përfaqësimin e grave në politikë, veçanërisht me miratimin e kuotave gjinore, mund të çojë në vendimmarrje më të balancuar gjinore, dhe kështu më legjitime, politike dhe publike*" (shih, paragrafin 4 të Rezolutës 1706 (2010)).
106. Në mënyrë specifike, përmes kësaj Rezolutive theksohet: "*Asambleja vlerëson se mungesa e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është një kërcënim për legjitimitetin e demokracive dhe shkelje e të drejtës themelore të njeriut për barazinë gjinore, dhe kështu rekomandon që vendet anëtare të korrigjojnë këtë situatë me përparësi nga: 6.3. reformimin e sistemit të tyre zgjedhor në një më të favorshëm për përfaqësimin e grave në parlament: 6.3.1. në vendet me sistem të listave me përfaqësim proporcional, të merret parasysh futja e një kuote ligjore e cila parashikon jo vetëm një pjesë të lartë të kandidatëve gra (idealisht të paktën 40%), por edhe një rregull të rreptë të renditjes së pozitive ..., dhe sanksione efektive (mundësisht jo financiare, por më tepër mospranimi i kandidaturave/listave të kandidatëve) për mospërputhje [...]."* (shih, paragrafin 6 të Rezolutës [1706 \(2010\)](#)).
107. Në vijim, përmes Rezolutës 2111 (2016) Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, përcaktoi që (i) "*kuotat zgjedhore janë mjeti më efektiv për të arritur progres të konsiderueshëm, të shpejtë, me kusht që ato të hartohen në mënyrë korrekte dhe të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Kuotat duhet të përshtaten me sistemin zgjedhor në fuqi, të vendosin objektiva ambicioze dhe të shoqërohen me sanksione të rrepta për mosrespektim.*"; dhe (ii) "*në dritën e këtyre konsideratave, Asambleja u bën thirrje vendeve anëtare dhe vëzhguese të Këshillit të Evropës [...] ato duhet, në veçanti: [...] të vendosin sanksione të zbatueshme për mosrespektimin e masave pozitive, siç është refuzimi i listave të kandidatëve.*" (shih, paragrafët 2 dhe 15 të Rezolutës [2111 \(2016\)](#)).
108. Përderisa në Rekomandimin Rec (2003) 3, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, është specifikuar që "*pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është çështje e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, e drejtësisë sociale dhe një kusht i domosdoshëm për funksionimin më të mirë të një shoqërie demokratike*" (shih, preambulën e Rekomandimit [Rec \(2003\) 3](#)).
109. Tutje, Rekomandimi Rec 1899 (2010) përkritazi me rritjen e përfaqësimit të grave në politikë nëpërmjet sistemit zgjedhor, inkurajon shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që të rrisin përfaqësimin e grave duke vendosur kuota. Sipas këtij Rekomandimi "*Vendet me një sistem të listave të përfaqësimit proporcional inkurajohen të (marrin parasysh) të prezantojnë një kuotë të detyrueshme e cila parashikon jo vetëm një përqindje të lartë të kandidatëve femra (në mënyrë ideale të paktën 40%), por edhe një rregull të rreptë*

të renditjes, për shembull, një “zinxhir” në mënyrë alternative kandidatëve burra/gra ose që çdo grup prej tre kandidatësh në listë (1-3, 4-6, 7-9, etj.) të përbëhet nga të paktën një kandidat të gjinisë më pak të përfaqësuar. Me rregullat e renditjes, si këto, kandidatet femra nuk rrezikojnë të vendosen shumë poshtë në listë për të pasur një mundësi reale për t'u zgjedhur. Vendet me sisteme shumicë ose pluraliste inkurajohen të paraqesin parimin e secilës parti që zgjedh një kandidat midis të paktën një kandidati femër dhe një mashkull në çdo qark partiak ose të gjejnë mënyra të tjera për të siguruar përfaqësim të shtuar të grave në politikë. Aty ku kuotat janë të mandatuara, ekzistojnë shqetësime se këto kuota në thelb do të krijojnë një tavan për avancimin gjinor duke u kërkuar palëve që të mbajnë gratë në vendet e nivelit të ulët për të siguruar përputhshmërinë (shih, paragrafët 2.1.1 dhe 2.1.2 të Rekomandimit 1899(2010)).

110. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet edhe Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore, përmes të cilit në pikën 2.5 (Barazia e gjinive) të tij është përcaktuar: “Rregullat ligjore, të cilat kërkojnë një përqindje minimale të personave të secilës gjini në numrin e përgjithshëm të kandidatëve, nuk duhen konsideruar si shkelje të parimit për votim të barabartë, në qoftë se kanë një bazë kushtetuese.”; përderisa pikën 25 të tij është specifikuar se: “Përveç kësaj, fushëveprimi i këtyre rregullave varet nga sistemi elektoral. Në një sistem mazhoritar në qoftë se numri i burrave dhe grave që kanë të drejtë të zgjidhen është i njëjtë atëherë kjo çon në barazi. Megjithatë, në rastin se aplikohet votimi preferencial ose votimi i kryqëzuar, zgjedhësit nuk janë të detyruar të zgjedhin kandidatë nga të dy sekset, dhe kjo mund të çojë në një përbërje të pabalancuar të organit si zgjedhje e vetë votuesve.” shih, Kodin e Praktikës së Mirë i Çështjeve Zgjedhore (shih, Udhëzimet dhe Raportin Shpjegues) (CDL-AD (2002) 23 rev), i miratuar nga Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (“Komisioni i Venecias”) në mbledhjen e tij të 51-të dhe 52-të dhe Raporti i tij Shpjegues (5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002).

(ii) *Raportet dhe opinionet relevante të Komisionit të Venecias*

111. Në vijim, dhe në kontekstin specifik të kuotave gjinore në lista të partive politike, Gjykata në vijim do t'i referohet: (i) Deklaratës mbi Pjesëmarrjen e Grave në Zgjedhje, miratuar nga Komisioni i Venecias më 9-10 qershor 2006; (ii) Raportit [CDL-AD(2009)029] mbi ndikimin e sistemeve zgjedhore në përfaqësimin e grave në politikë, i miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike më 14 mars 2009 dhe Komisioni i Venecias të miratuar më 12-13 qershor 2009; (iii) Raportit [CDL-AD(2020)023] mbi ligjin zgjedhor dhe administrimin e zgjedhjeve në Evropë, i miratuar më 8-9 tetor 2020; dhe (iv) Udhëzimeve [CDL-AD\(2010\)24](#) për rregullimin e partive politike, të miratuara nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias miratuar më 15-16 tetor 2010.
112. Komisioni i Venecias kishte theksuar “detyrimin për të siguruar përbërjen e listës së kandidatëve me radhitjen e burrave dhe grave.” (shih, ndër tjerash edhe Deklaratën mbi Pjesëmarrjen e Grave në Zgjedhje [(CDL-AD(2006)020), miratuar nga Komisioni i Venecias më 9-10 qershor 2006).
113. Sipas Raportit të Këshillit për Zgjedhje Demokratike dhe Komisionit të Venecias mbi ndikimin e sistemeve zgjedhore në përfaqësimin e grave në politikë është specifikuar se kuotat gjinore që synojnë të përmirësojnë ekuilibrin gjinor në politikë në parim përcaktojnë përqindjet minimale të kandidateve femra për zgjedhje, në listat e partive. Përveç kësaj, mund të ketë dispozita për renditje në listë. Kuotat gjinore mund të vendosen ligjërisht (“kuota ligjore”, “kuota të obligueshme” ose “kuota të detyrueshme”) ose ato mund të miratohen vullnetarisht nga partitë politike (“kuota vullnetare” ose “kuota partiake”). Kuotat ligjore janë të detyrueshme për të gjitha partitë që paraqesin kandidatë në parlament, ndërsa kuotat partiake kanë vetëm karakter vetë-detyrues për

partinë përkatëse. Të dy llojet e kuotave mund të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor (shih, Raportin mbi ndikimin e sistemeve zgjedhore në përfaqësimin e grave në politikë, i miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike më 14 mars 2009 dhe Komisioni i Venecias të miratuar më 12-13 qershor 2009, paragrafët 19-23).

114. Po i njëjti Raport, gjithashtu sqaron se deri në fund të vitit 2008, dymbëdhjetë (12) shtete anëtare të Këshillit të Evropës kishin miratuar kuota ligjore për zgjedhjet kombëtare. Megjithatë, Raporti sqaron: *“këto kuota ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme si në përqindjet minimale të kërkuara të kandidatëve femra në lista ashtu edhe në dispozitat e mundshme të renditjes për lista. Dispozitat për sanksionet ligjore për mospërrputhje ndryshojnë gjithashtu. Akoma më të zakonshme janë kuotat vullnetare: Në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, të paktën një parti parlamentare ka miratuar kuota vullnetare partiake. Vendet e rezervuara për gratë në parlament janë një lloj kuote e veçantë, e lidhur ngushtë me sistemin zgjedhor. [...]”* (shih, paragrafët 22 dhe 23 të Raportit [CDL-AD(2009)029] të sipërcituar).
115. Ky Raport, në kontekst të pasqyrimin të shteteve që kanë përfshirë kuota gjinore në sistemet e tyre respektive zgjedhore, shpjegon se Amerika Latine luan një rol udhëheqës në përdorimin e kuotave ligjore gjinore për zgjedhjet kombëtare (shih, shtetet si Argjentina, Bolivia, Brazili, Kolumbia, Kosta Rika, Republika Domenikane, Ekuador, Meksika, Panama, Peru dhe Venezuela), (shih paragrafin 86 të Raportit [CDL-AD(2009)029]).
116. Raporti, në vijim sqaron se ky parim i pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave e kupton praninë e grave dhe burrave në kontekstin në fjalë në atë mënyrë që as gjinia nuk përbën më shumë se gjashtëdhjetë e as më pak se dyzet (40%) për qind të totalit. Kjo formulë shkon përtej kuotës së thjeshtë ligjore gjinore dhe është përforcuar në Rekomandimin Rec (2007)17 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore (shih, paragrafin 87 të Raportit [CDL-AD(2009)029]). Në vijim, Komisioni i Venecias, duke u bazuar në këtë Raport të vitit 2009, sërish kishte vënë në dukje se kishte ritheksuar se: *“duke pasur parasysh nën-përfaqësimin e thellë të grave, kuotat duhet të shihen si masa pozitive për të kompensuar kufizimet strukturore, kulturore dhe politike në përfaqësimin e grave. Meqë kuotat ligjore janë të detyrueshme nga natyra, ato duket se janë të preferueshme për kuotat vullnetare të partive. Megjithatë, kuotat vullnetare mund, përveç kësaj ose në mënyrë alternative, të kontribuojnë gjithashtu në një rritje të përfaqësimit të grave, veçanërisht nëse ato zbatohen nga partitë e mëdha parlamentare. Për të qenë efektive, kuotat gjinore duhet të parashikojnë të paktën 30% të grave në listat e partive, ndërsa 40% ose 50% është e preferueshme.”* (shih, paragrafin 261 të Raportit CDL-AD (2020)023 mbi Ligjin zgjedhor dhe administrimin e zgjedhjeve, i cituar më lart).
117. Bazuar në këtë raport rezulton që (i) përderisa vetëm disa vende parashikojnë përqindjen e barabartë të grave dhe burrave në listat e partive (Belgjikë) ose në mesin e numrit të *“përgjithshëm të kandidatëve të partisë (Francë), në shumicën e rasteve minimumi i kërkuar i të dy gjinive është më i ulët: 40% në Spanjë, 35% në Slloveni, 33% në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Portugali, 30% në Shqipëri, “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” dhe Serbi, dhe 15% e listave të partive/bllokut në Armeni.”* dhe (ii) disa prej këtyre shteteve ofrojnë gjithashtu rregulla për radhitjen në listë. Në Spanjë kjo është në çdo vend të 5-të, ndërsa në Armeni gratë duhet të vendosen vetëm në çdo pozitë të 10-të. Në Bosnje dhe Hercegovinë duhet të ketë një kandidat të gjinisë së nënpërfaqësuar në mes të dy pozitave të para në listë, dy kandidatë në mesin e pesë të parëve dhe tre midis tetë të parëve. Në Belgjikë dy pozitat e para (në 2002: tri të parat) nuk duhet të plotësohen nga kandidatë të së njëjtës gjini. Megjithatë, asnjë nga kuotat ligjore nuk parashikon një *“sistem zinxhir”*, ku çdo kandidat tjetër në listë duhet të jetë grua. (shih, paragrafët 90-91 e Raportit [CDL-AD(2009)029]).

118. Komisioni i Venecias tutje specifikon se kuotat gjinore synojnë të përmirësojnë ekuilibrin gjinor në politikë. Ato përcaktojnë përqindjet minimale të kandidatëve femra për zgjedhje, zakonisht në listat e partive. Përveç kësaj, mund të ketë dispozita për renditje në listë. Kuotat gjinore mund të vendosen ligjërisht (“kuota ligjore”, “kuota të obliqueshme” ose “kuota të detyrueshme”) ose ato mund të miratohen vullnetarisht nga partitë politike (“kuota vullnetare” ose “kuota partiake”). Kuotat ligjore janë të detyrueshme për të gjitha partitë që paraqesin kandidatë në parlament, ndërsa kuotat partiake kanë vetëm karakter vetë-detyrues për partinë përkatëse. Të dy llojet e kuotave mund të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor. Deri në fund të vitit 2008, dymbëdhjetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës kishin miratuar kuota ligjore për zgjedhjet kombëtare (shih, paragrafët 19-23 të Raportit [CDL-AD(2009)029], i cituar më lart).
119. Është e rëndësishme të sigurohet që kuota të tilla t'u lejojnë grave në mënyrë efektive aftësinë për të përparuar në pozita drejtuese në vend që të krijojnë kufizime *de facto* për përparimin e tyre. Është një praktikë e mirë që të rishikohen periodikisht kuotat për të vlerësuar nëse ato duhet të mbahen në të njëjtin nivel ose nëse numri i tyre duhet të rritet, veçanërisht në nivelet e ulëta të qeverisjes (shih, Udhëzimet [CDL-AD\(2010\)24](#) për rregullimin e partive politike, të miratuara nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias miratuar më 15-16 tetor 2010, paragrafi 102).
- (iii) *Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, GjDBE-së dhe gjykatave kushtetuese në çështje zgjedhore*
120. GjEDNj-ja në praktikën e saj gjyqësore të konsoliduar ka theksuar se avancimi i barazisë gjinore, si synim madhor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo do të thotë se arsye me peshë do të duhej të parashtroheshin përpara se një ndryshim trajtimi për shkak të gjinisë të mund të konsiderohet si i pajtueshëm me KEDNj-në. Për më tepër, Gjykata është shprehur se në ditët e sotme avancimi i barazisë së gjinive në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e pengon shtetin të japë mbështetjen e tij ndaj pikëpamjeve të rolit të burrit si parësor dhe të gruas si dytësor (shih, rastin e GjEDNj-së, *Staatkundig gereformeerde Partij kundër Holandës*, nr. [58369/10](#), Vendim i 10 korrikut 2012, paragrafët 72 dhe 73).
121. Në një rast zgjedhor të shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, parashtruesit paraqitën listat e kandidatëve për zgjedhje në Asamblenë Kombëtare. Komisionet kompetente zgjedhore konstatuan se listat nuk përmbanin një numër të mjaftueshëm të kandidatëve gra dhe si rrjedhim nuk plotësonin kushtin e përcaktuar në nenin 43.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Kuvendit Kombëtar, pra kuotën gjinore. Ata i hodhën poshtë listat, duke i përjashtuar nga zgjedhjet. Parashtruesit dorëzuan ankesa në Gjykatën e Lartë, e cila konfirmoi vendimet e komisioneve zgjedhore. Më pas ata paraqitën ankesa kushtetuese duke pretenduar shkelje të së drejtës për t'u kandiduar në zgjedhje, pasi duhet t'u jepej mundësia për të korrigjuar listat e kandidatëve ose komisionet zgjedhore duhet të kishin hequr numrin e nevojshëm të kandidatëve burra nga listat e tyre.
122. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë rikujtoi se neni 43.4 i Kushtetutës kërkon që ligji të parashikojë masa për nxitjen e mundësive të barabarta të burrave dhe grave për t'u zgjedhur në organet shtetërore dhe organet e bashkësisë lokale. Ajo sqaroi se kjo dispozitë përfshin bazën kushtetuese të nenit 43.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare, i cili përcakton se në listën e kandidatëve secila gjini nuk mund të përbëjë më pak se tridhjetë e pesë përqind (35%) të numrit të përgjithshëm aktual të kandidatëve gra dhe burra në listë. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë shpjegoi se sipas parimit të zgjedhjeve periodike, zgjedhjet duhet të kryhen në intervale të rregullta dhe të gjitha detyrat e nevojshme zgjedhore duhet të kryhen brenda një periudhe relativisht të

shkurtër kohore. Afatet kohore të përcaktuara me Kushtetutën e Sllovenisë për zgjedhjet për Asamblenë Kombëtare janë veçanërisht të shkurtra dhe për këtë arsye miratimi i afateve kohore shumë të shkurtra në ligjin që rregullon këto zgjedhje është i justifikuar. Dallimi ndërmjet mangësive formale dhe thelbësore të listave të kandidatëve është një mjet për të siguruar që të gjitha listat e kandidatëve të jenë të disponueshme në kohë. Një mangësi formale është një mangësi që mund të korrigjohet pa qenë nevoja për të kryer ndonjë detyrë të re zgjedhore në procedurën e emërimit, ndërsa mangësia që kërkon kryerjen e detyrave shtesë është e një natyre thelbësore. Sipas Ligjit të Zgjedhjeve të Asamblesë Kombëtare, komisionet zgjedhore janë të autorizuara vetëm të kërkojnë që mangësitë formale të korrigjohen. Nëse lista e kandidatëve nuk është përpiluar në përputhje me kuotën e kërkuar gjinore, kjo nuk paraqet një mangësi formale, por më tepër thelbësore; e gjithë procedura e emërimit do të duhej të përsëritej për ta korrigjuar atë. Prandaj, një komision zgjedhor nuk është i autorizuar të kërkojë që një mangësi e tillë të korrigjohet. Duhet ta refuzojë atë. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë shtoi gjithashtu se një komision zgjedhor nuk mund të ndërhyjë në listën e kandidatëve për të siguruar që ajo plotëson kuotën gjinore pasi i mungon baza e shprehimore ligjore për këtë. Ajo theksoi se nuk është në kundërshtim me Kushtetutën nëse nga partitë politike kërkohet të veprojnë me zell gjatë emërimit të kandidatëve. Nëse ata nuk e bëjnë këtë, refuzimi i listës së kandidatëve sjell një ndërhyrje në të drejtën e votës që duhet t'i atribuohet mungesës së kujdesit të tyre dhe jo sjelljes së autoriteteve shtetërore. Ajo konkludoi se kushtet e përcaktuara nga neni 55b.2 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk ishin plotësuar dhe nuk pranoi ankesat kushtetuese për shqyrtim në merita (shih, Vendimin Up-716/18 dhe Up-745/18 të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, të 17 majit 2018).

123. Të njëjtit parashtrues kishin dorëzuar edhe kërkesë në GjEDNj. Parashtrësia e tyre në GjEDNj u regjistrua si çështja *Meta Zevnik dhe të tjerët kundër Sllovenisë*.
124. Në çështjen *Meta Zevnik dhe të tjerët kundër Sllovenisë*, parashtruesit u ankuan në GjEDNj se kuota zgjedhore prej 35% mbi bazën e së cilës u refuzua lista e kandidatëve ka cenuar të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së. GjEDNj kishte theksuar: "*GJEDNJ-ja e konsideron veçanërisht të rëndësishme të theksohet se Shteteve Kontraktuese duhet t'u jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi në këtë sferë, duke parë se ekzistojnë mënyra të shumta për organizimin dhe drejtimin e sistemeve zgjedhore dhe një mori dallimesh, ndër të tjera, në zhvillimin historik, diversitetin kulturor dhe mendimi politik brenda Evropës, të cilin secili Shtet Kontraktues ta formojë në vizionin e tij demokratik*" (shih, rastin e GjEDNj-së, *Meta Zevnik dhe të tjerët kundër Sllovenisë*, nr. [54893/18](#), Vendim i 12 nëntorit 2019, paragrafi 31).
125. Në vijim, GjDBE-ja në çështjen *Abrahamsson dhe Leif Anderson kundër Elisabet Fogelqvist* lidhur me vlefshmërinë e legjislacionit suedez që parashikonte rregullin që thoshte se një kandidat i gjinisë së nënpërfaqësuar që posedon kualifikime të mjaftueshme për të kryer punën në një pozitë duhet t'i akordohet përparësi përveç nëse "*dallimi ndërmjet kualifikimeve të kandidatëve është aq i madh sa që do të shkelte kriterin e objektivitetit në emërim.*" konstatoi se ligji me efekt automatik u akordonte përparësi kandidatëve të gjinisë së nënpërfaqësuar. Fakti që dispozita në fjalë parandalonte përparësinë automatike vetëm në rastet ku kishte dallim domethënës në kualifikime nuk ishte e mjaftueshme që të parandalojë efektet jo-proporcionale të asaj dispozite (shih, rastin e GjDBE-së *Abrahamsson dhe Leif Anderson kundër Elisabet Fogelqvist*, 6 korrik 2000).
126. Një padi civile e vitit 2012 ishte paraqitur në Gjykatën Zgjedhore të Gjqësorit Federal të Meksikos. Aktet e kundërshtuara përfshinin vendimin e Partisë së Veprimit Kombëtar (*National Action Party*) për të anuluar disa nominime për përfaqësuesit dhe

senatorët federalë, mbi parimin e shumicës relative në përputhje me kuotën gjinore të përcaktuar në nenin 219 të Kodit Federal Zgjedhor. Këshilli i Përgjithshëm i Institutit Federal të Zgjedhjeve miratoi zëvendësimin e nominimeve të përmendura. Pas dëgjimit të rastit, Gjykata Zgjedhore e Gjyqësorit Federal të Meksikos vërtetoi aktet e kontestuara. Në dritën e parimeve që garantojnë barazi dhe mosdiskriminim, Gjykata Zgjedhore e Gjyqësorit Federal të Meksikos arsyetoi se qëllimi i nenit 219 të Kodit Federal Zgjedhor është të sigurojë mundësi të barabarta dhe barazi gjinore në jetën politike dhe të promovojë pjesëmarrjen politike të të dy gjinive, duke u ofruar atyre mundësinë e qasje të barabartë në pozitat zyrtare në zgjedhjet popullore. Gjykata Zgjedhore e Gjyqësorit Federal të Meksikos u shpreh se ankesat e paditësve ishin të pabazuara. Arsyeja është se edhe pse kanë fituar nominimet e brendshme sipas procedurave partiake, zëvendësimi i bërë nga partia propozuese ishte i justifikuar në bazë të parimeve të shtetit ligjor demokratik, që përfshin barazinë gjinore në integrimin e nominimeve. Ky parim duhet të merret parasysh pavarësisht nga metoda e përzgjedhjes brenda partisë (shih, Vendimin SUP-JDC-475 të Gjykatës Zgjedhore të Gjyqësorit Federal të Meksikës, të 24 prillit 2012).

127. Mbi bazën e propozimit të Partisë Demokratike të Gruas, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë shqyrtoi përputhshmërinë me Kushtetutën të neneve ose pjesëve të neneve 8, 12, 13 dhe 14 të Ligjit për Ndryshimet në Zgjedhjen e Anëtarëve të Ligjit për Parlamentin Kroat dhe mori vendim për shfuqizimin e tyre, d.m.th. u shfuqizuan nenet ose pjesë të neneve 9.4.2.3, 20.4, 20.7, 21.2, 21a.2 të tekstit të konsoliduar të Ligjit për Zgjedhjen e Anëtarëve të Parlamentit të Kroacisë. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë po ashtu shqyrtoi "kuotën gjinore" të detyrueshme në listat e kandidatëve. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë deklaroi në vendimin e saj se rregulli ligjor, sipas të cilit në listat e kandidatëve duhet të jenë minimalisht dyzet përqind (40%) e anëtarëve të secilës gjini, duhet të mbetet në fuqi. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë u shpreh se detyrimi ligjor që përcaktonte se një minimum prej dyzet përqind (40%) të anëtarëve të secilës gjini duhet të përfshihen në listat e kandidatëve ishte ende në fuqi në zgjedhjet parlamentare të 2015-së dhe gjithashtu ishte parashikuar një gjobë për mosbindje (shih, Vendimin U-I-1397/2015 të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, të 24 shtatorit 2015).

B. Vlerësimi i Gjykatës

128. Gjykata thekson që fushëveprimi i kësaj kërkesë në aspektin përmbajtësor, respektivisht thelbi i çështjes që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e nenit 28 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, përkatësisht vlerësimi nëse përcaktimi prej kuotës prej së paku tridhjetë (30%) të përfaqësimit të secilës gjini në listën e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, cenon të drejtat zgjedhore të përcaktuara në nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës. Me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë të nenit 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Gjykata fillimisht dhe ndër tjerash, ka shtjelluar (i) parimet e përgjithshme të Kushtetutës dhe KEDNj-së përkitazi me të drejtën për t'u zgjedhur dhe pjesëmarrjen; (ii) instrumentet dhe dokumentet e miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës që ndërlidhen me marrjen e masave afirmative për përfaqësim të barabartë në politikë; (iii) përmbledhjet e rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias për kuotat gjinore në lista zgjedhore si masa të veçanta për të adresuar pabarazinë faktike në mes të gjinive në përfaqësim politik; dhe (iv) praktikën gjyqësore të Gjykatës, të GJEDNj-së, të GJDBE-së dhe gjykatave të vendeve tjera në lidhje me të drejtat zgjedhore dhe kuotat gjinore.
129. Gjykata, fillimisht rithekson se nevoja e krijimit të mundësive të barabarta, ashtu siç është përcaktuar edhe në dispozitën e kontestuar, përkatësisht nenit 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme krijon për shtetin detyrime pozitive për përcaktimin e masave

të ndryshme, duke përfshirë edhe normime ligjore, me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor, ndër tjerash në politikë. Në kontekst të sigurimit të barazisë gjinore, me nenin e kontestuar 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është përcaktuar kuota minimale, që specifikon se në listat zgjedhore, përkatësisht në listat e kandidatëve të subjektit politik, i cili garon në zgjedhje të përgjithshme, të jenë së paku *“tridhjetë (30 %) për qind meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra”*. Në frymën e këtij përcaktimi ligjor, Gjykata sqaron se sipas Kushtetutës, përderisa të gjithë janë të barabartë para ligjit, parimet e mbrojtjes së barabartë nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë për shkak se masat e tilla të veçanta paraqesin instrumente me të cilat shteti, respektivisht Republika e Kosovës, zhvillon politikën e mundësive të barabarta të dhe të tilla masa mund të zbatohen deri në realizimin e qëllimit për të cilin edhe janë vendosur.

130. Në kuptim të kësaj, Gjykata vë në dukje edhe rekomandimet dhe opinionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias, respektivisht, të cilat theksojnë se kuotat gjinore zgjedhore mund të konsiderohen si *“një masë e përshtatshme dhe legjitime për të rritur përfaqësimin parlamentar të grave”*, dhe në këtë frymë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës u kërkohet të lejojnë veprime pozitive ose masa të veçanta që të miratohen në mënyrë që të arrijnë përfaqësim të ekuilibruar në vendimmarrjen politike dhe publike.
131. Gjykata gjithashtu nënvizon se neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] i Kushtetutës garanton të drejtën për të zgjedhur (aspektin aktiv të votës), si dhe të drejtën për t’u zgjedhur (aspektin pasiv të votës). Më specifikisht, aspekti pasiv i votës që reflektohet në të drejtën për t’u zgjedhur, paraqet një të drejtë specifike relevante në këtë rast konkret, i takon kandidatëve si individë, përkatësisht si persona fizikë, të cilët garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror, si dhe subjekteve politike, përkatësisht personave juridikë që garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror. Të drejtat e garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës dhe nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së janë të drejta qenësore drejt krijimit dhe mbajtjes së themeleve të një demokracie efektive dhe të vlefshme që udhëhiqet nga sundimi i ligjit. Në këtë kuptim, GjEDNj përmes praktikës së saj gjyqësore ka nënvizuar se shtetet janë të lira të thirren në *“qëllimet e tyre”* specifike kur kufizojnë ushtrimin e kësaj të drejte me kushtin që qëllimet e tilla të jenë: (i) në pajtim me parimin e sundimit të ligjit; dhe (ii) objektivave të përgjithshme të Konventës.
132. Gjykata vlerëson se kuota minimale e përfaqësimit prej tridhjetë përqind (30%) të të dy gjinive, në kontekst të kompetencës së Kuvendit si ligjvënës dhe hapësirës së vlerësimit (*margin of appreciation*) përcaktohet në varësi të rrethanave dhe obligimit për progres të vazhdueshëm për pjesëmarrje të barabartë të të dy gjinive në procese zgjedhore, si shtylla kryesore e zhvillimit të demokracisë. Megjithatë, Gjykata rithekson se (i) nuk është detyrë e saj që të vë në diskutim përzgjedhjen e politikës publike të organit ligjvënës përderisa e njëjta nuk është e paarsyeshme dhe në kundërshtim me parimet e mishëruara me Kushtetutë dhe praktikat e mira ndërkombëtare; dhe (ii) fokusi i vlerësimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është gjithmonë në kuptim të respektimit të normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka çuar tek miratimi i ligjit të caktuar nga ana e organit ligjvënës.
133. Në kuptim të përcaktimit të kuotave gjinore me Ligj, Aktgjykimi i referohet edhe qëndrimin të GjEDNj-së, e cila përmes praktikës së saj gjyqësore kishte theksuar se Shteteve Kontraktuese duhet t’u jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi në këtë sferë, duke parë se ekzistojnë mënyra të shumta për organizimin dhe drejtimin e sistemeve

zgjedhore dhe një mori dallimesh, ndër të tjera, në zhvillimin historik, diversitetin kulturor dhe mendimi politik brenda Evropës, të cilin secili Shtet Kontraktues ta formojë në vizionin e tij demokratik.

134. Në këtë kuptim, Gjykata vë në dukje edhe Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, përmes të cilit shtetet anëtare të Këshillit të Evropës inkurajohen që të rrisin përfaqësimin e grave duke vendosur kuota. Përveç kësaj bazuar në këto rekomandime dhe opinionet e Komisionit të Venecias, Aktgjykimi sqaron që të njëjtat si emërues të përbashkët kanë (i) përcaktimin e një kuote minimale të përfaqësimit në lista zgjedhore të subjekteve politike dhe (ii) një përcaktim të renditjes zinxhir (*zipper system*) të kandidatëve nga secila gjini ose nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve në rast të kuotës prej tridhjetë përqind (30%), kjo e fundit me synimin që kandidatët e gjinisë më pak të përfaqësuar të mos rrezikojnë që të vendosen shumë poshtë në listë dhe të kenë një mundësi reale për t'u zgjedhur.
135. Në kuptim të së parës, dhe bazuar në elaborimin e shtjelluar në Aktgjykim, Gjykata thekson që kuota minimale prej tridhjetë përqind (30%) e përcaktuar me nenin 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe praktikën relevante ndërkombëtare sipas elaborimit si më sipër, është një masë e nevojshme afirmative, për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë dhe e cila zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilën është vënë ajo. Përcaktimi i lartësisë së kësaj, përkatësisht kuote të përfaqësimit gjinor në lista të subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, duke i lënë hapësirën e nevojshme pushtetit legjislativ, përkatësisht Kuvendit për të përcaktuar lartësinë e kësaj kuote, në përputhje me detyrimet pozitive të shtetit për të arritur idealin kushtetues të barazisë gjinore në Republikën e Kosovës, dhe e cila, pasi të jetë caktuar duhet të zbatohet me përpikmëri.
136. Siç është shtjelluar më sipër, një numër shtetesh anëtare të Këshillit të Evropës kanë vendosur mekanizma të tillë në ligjet përkatëse që rregullojnë përcaktimin e listave zgjedhore të subjekteve politike që garojnë në zgjedhje. Rezoluta 1706(2010) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës rekomandon që në vendet me sistem të listave me përfaqësim proporcional, të merret parasysh futja e një kuote ligjore e cila parashikon jo vetëm një pjesë të lartë të kandidatëve gra (idealisht të paktën dyzet përqind (40%), por edhe një rregull të rreptë të renditjes së pozitive. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, mesatarja e kuotës së përcaktuar për përfaqësim gjinor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat kanë vendosur kuota gjinore është prej njëzet përqind (20%) deri në dyzet përqind (40%).
137. Në anën tjetër dhe ndërlidhur me pretendimet e Avokati të Popullit për detyrim të përfaqësimit të barabartë për secilën gjini në lartësinë prej pesëdhjetë përqind (50%), Gjykata rikujton që ajo tashmë ka adresuar këtë çështje përmes praktikës së saj gjyqësore, përfshirë rastet KI45/20 dhe KI46/20. Në këtë rast, ndër tjerash është theksuar që: *“nuk i takon Gjykatës që të rivendosë kuota të reja ligjore ose të rrisë përqindjen e kuotave ligjore të përfaqësimit gjinor në favor të asnjërës gjini. Ligjvënësit e Republikës së Kosovës janë ata që kanë vendosur kuotën prej 30% si kuotë të vetme ligjore të aplikueshme, e cila duhet të ruhet në çdo rrethanë përderisa autoritetet kompetente nuk vendosim që të bëjnë ndryshime ligjore në këtë aspekt, nëse ato e shohin të nevojshme. Janë gjithashtu ligjvënësit ata që kanë caktuar 50%-shin si ideal kushtetues të përfaqësimit të barabartë gjinor duke theksuar se përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet vetëm kur sigurohet përfaqësim 50-50 për secilën gjini.”* (shih, paragrafin 143 të Aktgjykimit në rastet [KI45/20](#) dhe [KI46/20](#)).

138. Në kuptim të së dytës, përkatësisht në kuptim të renditjes, Gjykata vlerëson se përcaktimi në paragrafin 1 të nenit 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që listat zgjedhore të përmbajnë nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë, është i bazuar edhe në standardet e rekomanduara ndërkombëtare, siç janë elaboruar në këtë Aktgjykim. Në këtë kontekst, Gjykata vë në dukje se ligji garanton një kandidat të secilës gjini të përfshirë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve, por ky është kufiri minimal i përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar. Gjykata thekson që pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është çështje e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, e drejtësisë sociale dhe një kusht i domosdoshëm për funksionimin më të mirë të një shoqërie demokratike (shih, ndër tjerash, Memorandumin Shpjegues për Rekomandimin Rec (2003) 3 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës përkitazi me *“Pjesëmarrjen e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike”*).
139. Në vijim, Gjykata duke vënë në dukje paragrafin 3 të nenit 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton që KQZ ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një për qind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë për qind (30%) në momentin e certifikimit, vlerëson se një përcaktim i tillë po ashtu është në pajtim me rekomandimet në nivel të Konventës CEDAW dhe të Këshillit të Evropës, të cilat rekomandojnë që legjislacioni duhet që të mundësojë mbështetje financiare për subjektet politike të cilat mundësojnë përfaqësim të balancuar gjinor. Për dallim nga Ligji i mëhershëm për Zgjedhje të Përgjithshme, ky përcaktim në Ligjin e kontestuar përbën një risi, dhe për rrjedhojë i motivon subjektet politike që të përfshijnë më shumë gra në listat e kandidatëve për zgjedhje të përgjithshme.
140. Në vijim, dhe në kuptim të pretendimit të Avokatit të Popullit që ndërlidhet me qëllimin e synuar të përfaqësimit prej pesëdhjetë përqind (50%) të vendosur në Ligjin për Barazi Gjinore, Gjykata duke iu referuar paragrafit 8 të nenit 6 (Masat e Veçanta) të Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore që synon arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive, Gjykata në kontekst të evoluimit historik të konceptit të barazisë gjinore, sqaron se (i) koncepti i barazisë gjinore është dinamik dhe evoluon në mënyrë progresive në drejtim të plotësisht të idealit sublim të barazisë në përfaqësim të grave dhe burrave në relacionin pesëdhjetë përqind (50%) me pesëdhjetë përqind (50%); (ii) mirëpo, në kuptim të vlerësimit të Ligjit të kontestuar, kuota prej tridhjetë përqind (30%) qartazi paraqet kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë së nënpërfaqësuar, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar.
141. Për më tepër, ashtu siç është theksuar edhe në praktikën e deritanishme të saj gjyqësore, Gjykata është e vetëdijshme që nuk është në kompetencën e saj që të caktojë politika të reja publike e as të vlerësojë nëse një politikë publike e deritashme është e mirë apo e duhur. Gjithashtu, nuk i takon Gjykatës që të rivendosë kuota të reja ligjore ose të rrisë përqindjen e kuotave ligjore të përfaqësimit gjinor në favor të asnjërës gjini. Ligjvënësit e Republikës së Kosovës janë ata që kanë vendosur kuotën prej tridhjetë përqind (30%) si kuota ligjore në listat zgjedhore të subjekteve politike, e cila duhet ruhet në çdo rrethanë përderisa autoritetet kompetente nuk vendosin që të bëjnë ndryshime ligjore në këtë aspekt, nëse dhe kur ata e konsiderojnë një gjë të tillë si të nevojshme, përderisa respektojnë përcaktimet kushtetuese dhe standardet e mirë-vendosura ndërkombëtare, në veçanti ato që garantojnë që vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Në anën tjetër, janë gjithashtu ligjvënësit ata që kanë caktuar pesëdhjetë përqindshin (50%-shin) si ideal të përfaqësimit të barabartë gjinor duke theksuar se përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet vetëm kur sigurohet përfaqësim 50-50 për secilën gjini. Thënë këtë, që të dyja janë ligje të miratuara në Kuvend dhe i takon këtij të fundit, që gradualisht të arrijë përcaktimet që vetë ka miratuar drejt arritjes së idealeve kushtetuese.

142. Në këtë kuptim, Kuvendi ka autorizimet e plota që të avancojë lartësinë e kuotës së lartcekur që ndërlidhet me listat e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, gjithnjë në kontekst të një mase të nevojshme, derisa të jetë arritur qëllimi për të realizuar barazinë gjinore në Republikën e Kosovës dhe gjithnjë në pajtim me standardet e përcaktuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës, të elaboruara në këtë Aktgjykim.
143. Në fund, Gjykata duke marrë për bazë argumentimin e pamjaftueshëm të parashtruesit të kërkesës në njërën anë, dhe hapësirën e gjerë të vlerësimit që i akordohet ligjvënësit në çështje të përzgjedhjes së politikës publike dhe trendin e përfaqësimit nga njëzet përqind (20%) deri dyzet përqind (40%) të ndjekur nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat kanë vendosur kuota gjinore, vlerëson se përcaktimi i kuotës minimale prej tridhjetë përqind (30%) në listat e kandidatëve të subjekteve politike që garojnë në zgjedhjet e përgjithshme nuk është në kundërshtim me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.
144. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme nuk është në kundërshtim me të drejtën për t'u zgjedhur të garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 22, 29 dhe 30 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 19 dhjetor 2024:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk është në kundërshtim me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

